

Dorëheqjet

Dorëzohen anëtarët e KSHZ-së

Fq.5



PRIORITETE

Pas Buxhetit, zhvillime dinamike në Parlament

Fq.4



I kënaqur me paraqitjet, por jo edhe me rezultatet

Fq.19



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3243 · e mërkurë 13 dhjetor 2017

0°C | +6°C

15 DEN



Shundi ka sulmuar muzikën e mirëfilltë

Fq.12-13

EDITORIAL

Ta barazosh Fetain me Tarçullovskin!



Tridhjetë ditë paraburgim për Feta Alimin, "policin" e Orizares të Likovës, ka shqiptuar dje Gjykata Penale e Shkupit, ndërsa akuzohet se bashkë me deputetët e VMRO-së dhe huliganë tjerë, kanë rrezikuar jetët e deputetëve të opozitës, natën e përgjakshme të 27 prillit të këtij viti! Të hënën, Fetai në gjykatë ishte paraqitur me avokatin, dhe pas një ore

Fq.2

RAJON

Dialogu s'do të jetë peng i mungesës së Ekipit të Unitetit

Fq.14

GLOBI

Irani mbështet "luftën" e Hamasit

Fq.15



VIZITË HISTORIKE E ZAEVIT NË PRISHTINË

PA DOREZA ME KOSOVËN



Zaev gjithashtu ka theksuar se me kryeministrin e Kosovës, Haradinaj, kanë biseduar për projektet e përbashkëta, për avancimin e komunikimit ndërmjet dy shteteve, Kosovës dhe Maqedonisë. Ndërkaq, kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosovën dhe Maqedoninë i lidh orientimi euroatlantik i të dyja vendeve

Fq.3

Viti 2017, viti më i keq ekonomik

Shkup, 12 dhjetor - Në vitin 2017, përkatësisht në 9 muajt e parë zhvillimi ekonomik, më në fund po lëviz nga zona negative. Kështu e vlerësojnë ekspertët ekonomik raportin e fundit zyrtar të Entit Shtetëror të Statistikës. Për periudhën qershor deri në fund të muajit shtator Bruto Prodhimi Vendor (BPV) është rritur vetëm 0.2 për qind. Kjo, sipas ekspertëve, tregon qartë për praktikatat e këqija ekonomike të

Qeverisë së mëparshme, ndërkohë që shifra prej 0.2 për qind e rritjes së BPV-së në kuartaletin e tretë, është rritje reale ekonomike e jo si shifrat që i frynte Qeveria paraprake. Sipas Fatmir Bytyqit, ekspert ekonomik, edhe pse rritja e BPV-së prej 0.2 për qind është tepër e ulët, jep një optimizëm se Maqedonia po lëviz drejtë përmirësimit të gjendjes ekonomike në përgjithësi. "Vitin 2017, si duket..."

Fq.6



EDITORIAL

TA BARAZOSH
FETAËN ME
TARÇULLOVSKIN!Vedat MEMEDALIU
kryeredaktor

Tridhjetë ditë paraburgim për Feta Alimin, "policin" e Orizares të Likovës, ka shqiptuar dje Gjykata Penale e Shkupit, ndërsa akuzohet se bashkë me deputetët e VMRO-së dhe huliganë tjerë, kanë rrezikuar jetët e deputetëve të opozitës, natën e përgjakshme të 27 prillit të këtij viti! Të hënën, Fetai në gjykatë ishte paraqitur me avokatin, dhe pas një ore, nën shoqërimin e policisë, ai u dërgua në qelitë e Shutkës. Aktakuza ndaj tij akoma nuk është e qartë. Ndryshe nga akuza për "terrorizëm" që ngarkohen gjashtë deputetët e VMRO-së dhe huliganët tjerë maqedonas, Fetai përmendet në formë spekulimi gjithandej në media. Dhe në gjithë këtë mjegull, çuarja e Fetait në Shutkë tregon shumë për gjyqësorin e kalbur të këtij shteti. Ta barazosh Fetain me Tarçullovschin, të dënuarin e Gjykatës së Hagës e që u bë edhe deputet, është njëjtë sikurse ta barazosh një ushtar të UÇK-së me Millosheviqin. Krahasimi nuk është i tepruar, jo. Sepse vetëm gjyqësori i shkapërdhur i Maqedonisë dëshiron të barazojë viktimën me terroristin. Vetëm në Maqedoni ndodhë që, shpëtuesi i një jete të futet në qeli bashkë me vrasësin. Dhe e gjithë kjo për të zbutur revoltën maqedonase edhe me një shqiptar të pafajshëm në qeli.

Të përkujtojmë pak historinë e Tarçullovschit. Ai vrau shqiptarë të pafajshëm në Luboten. Edhe Erxhanin e vogël madje. U dënua për krime lufte nga Haga, ndërsa Qeveria e Maqedonisë e shpërbleu me post deputeti, ndërsa për pesë vite - familja e Tarçullovschit u shpërblye me 5000 euro në muaj. Dhe me gjithë privilegjet që një vrasës as nuk mund ti ëndërroj, Tarçullovschi nuk u ndal. Përkundrazi, mendoi se mund të hakmerret ndaj Hagës, por në kurriz të shqiptarëve. Ai bashkë me kolegët tjerë deputet i morën çelësat e Parlamentit nga duart e Fetait dhe lejuan hyrjen e dhunshme të huliganëve, të cilët të gjakosur dhe zvarrë tërhoqën Selën korridoreve pafund të Parlamentit.

Të kthehem te Fetai. "Policin" i Orizares arriti të bëjë atë që shumë nga ne - nëse do ishim në vend të tij, do iknim apo do bëheshim sikur të "vdekur". Por jo, Fetai u ngrit në këmbë dhe arriti ta marrë në duar Selën nga vrasësit e mundshëm.

Fetai, sigurisht se do dalë i lirë. Do të dalë sepse ndryshe gjyqësori bashkë me Qeverinë tregojnë se nuk dallohen nga Qeveria e mëparshme. Do të dalë sepse Fetai ishte viktimë, u rrah dhe shpëtoi Selën nga vdekja e sigurt. Do të dalë sepse çdo njeri human, atë natë, ishte vet Fetai. Vetëm se ndryshe nga netë tjerët, Fetai kreu detyrën me dinjitet - bëri atë që duhej guxim për të bërë - shpëtoi një jetë njeriu dhe me këtë, shpëtoi dhe shtetin.

PROCESET E NISURA MË 1939

"Kosova, shqiptarët dhe krejt Ballkani Perëndimor janë duke hyrë në një ndër fazat e fundit të proceseve të nisura me 1989. Fazat që kanë mbetur janë shumë të vështira dhe të rëndësishme. Mund të thuhet që 18-36 muajt e ardhshëm nevojiten bashkërenditje tonë po aq sa vitet e 90-ta kur vuanim dhe sakrifikonim si pak popuj në historinë njerëzore. Si atëherë, edhe sot, duhet të bashkohemi rreth strumbullarit të interesit të përgjithshëm. Fatkeqësisht në çdo popull ka individë dhe klane që vendosin interesat partikulariste mbi ato të përgjithshme, por popujt dhe strukturat politike të mençura i mënjanojnë njerëzit e tillë nga qendra e vendimmarrjes dhe influencës. Organizatat tona politike, por dhe të gjithë personat në pozita me përgjegjësi, duhet të jenë gati për proceset e reja duke tejkaluar meskinitetet. Të gjithë, që e duam interesin e popullit tonë më shumë se egoizimin personal dhe klanor, në parti të ndryshme dhe shtetet tona, duhet të pozicionohemi në frontin e ridefinimit të Ballkanit të bashkuar rreth qëllimit dhe angazhimit të dalim sa më mirë dhe të marrim maksimumin", shkruan në FB, publicisti Uk Lushi.



VETËVENDOSJE E TRE GRUPEVE

"Në VV problemi është i përmasave të pa riparueshme, e vetmja dilemë është kush me kë po bëhet dhe në këtë fazë kemi tri grupe njerëzish: ata që kanë marrë anë nga Albini, ata që kanë marrë anë nga Shpendi dhe Molliqaj, si dhe ata që nuk kanë guxim të pozicionohen. Grupin e atyre të pa pozicionuar në përqindje të madhe e kontrollon Dardan Molliqaj, sepse shumë nga ata i ka punësuar ose ka material për ti shantazhuar. Ajo që dihet sigurt është se fundi nuk do të jetë i lumtur", shkruan ish-anëtari i Lëvizjes Vetëvendosje në Pejë, Arton Muhaxheri.



FRIKA E LULZIM BASHËS

"Lulzim Basha është koha për të vënë drejtësinë mbi frikën nga drejtësia; dialogun mbi çdo mjet tjetër politik; negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në BE mbi gjithçka që na ndan në parti të ndryshme", shkruan në profilin e tij zyrtar, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.



"GRUPI I VIBERIT" SHARROI NË SHIT!

"Inati i madh. Me të rrëzuar fjala me tri shkronja. Dhe fjala më e ndaluar dhe më e ndyrë në fjalor. Se, dihet mirëfilli, kush luan me 'm't'in', prej tij i qet zorrët. Falje nuk ka. Qysh i thuhet njeriut 'Më fal pse mendoj që je mut'! Nuk kërkon falje njeriu serioz për bindjet e veta. Pse po zbrapsesh tash! Mbroji bindjet t'ua deri në fund, mbasi je aq rr.s. Problemi i Aida Dërgutit është se Albin Kurti nuk është 'm.t.', dhe se prepotenca e saj është aq gjigante, sa që ajo ka shkuar aq larg, sa plus kujton se është më dikushi se Albini. Katundarët në Vushtrri e njohin Turguten për arrogante dhe që ia mban kishe e shtirë si 'mashkull'. Njerëzit presin nga një femër të sillet elegante dhe e matur, si femër, e jo si mashkull i keq. Aq e frustruar që është zoja sa nuk e sheh emrin e Albin Kurtit në krye të kresë të përfshirë 'në grup të viberit' dhe kujton Aida që po flet veç me rivalin e saj më të madh në arrogancë e shëmti, Molliqajn", shkruan publicistja Kimete Berisha në FB.



MEDIACitate

Shqipëria ka njohur progres në përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut. Këtë e tha Ambasadorja e Bashkimit Evropian, Romana Vlahutit, gjatë konferencës vjetore të Avokatit të Popullit mbajtur në Tiranë. Vlahutit tha se respektimi i të drejtave të njeriut është pikë thelbësore për të ardhmen e fëmijëve tanë. "Dhuna në familje, shkelja e të drejtave të njeriut...etj, janë mjaft problematike në një shoqëri që do të njoh progres. Pasojat e dhunës në familje janë shumë të rënda. Sa i takon Shqipërisë, është bërë progres në përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut. Të gjithë duhet të japim kontributin tonë për të përmirësuar të ardhmen e fëmijëve tanë", tha Ambasadorja e BE, Vlahutit. "Për BE mbrojtja e të drejtave të njeriut është kyç për Bashkimin Evropianë.", shtoi Vlahutit.

(Lexo.al, 12 dhjetor)

Një shpërthim i madh ka ndodhur në një impiant të gazit natyror në lindje të Austrisë, duke shkaktuar vdekjen e një personi dhe plagosjen e së paku 18 të tjerëve, tha policia. Shpërthimi ka ndodhur në lokacionin Baumgarten, rreth orës 08:45, dhe është pasuar me zjarr. Impianti ndodhet në lindje të Vjenës, pranë kufirit me Sllovinë. Policia e Austrisë tha në Twitter se situata është nën kontroll dhe se shpërthimi është shkaktuar nga një problem teknik. Baumgarten është qendër për gazin e importuar rus, i cili dërgohet në Gjermani dhe Itali.

(REL, 12 dhjetor)

Në kulmin e debatit politik për zgjedhjen e pasuesit të Adriatik Llallës, ambasadori amerikan Donald Lu deklaroi se ka ikur koha e një kryeprokurori që nuk ndjek deri në fund çështjet penale. Sipas tij, lufta kundër politikanëve të korruptuar duhet të jetë prioritet. Diplomati amerikan tha se mazhoranca dhe opozita duhet të gjejnë gjuhën e përbashkët për zgjedhjet e kreut të ri të organit të akuzës. Diplomati Lu u shpreh se presidenti Amerikan dhe Sekretari i Shtetit luftojnë për reformën në drejtësi në Shqipëri.

(Vizion Plus, 12 dhjetor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

SHIME DESHPALI

Shime Deshpali (1897-1981) ishte shkrimtar arbëresh. Lindi në fshatin Arbënesht të Zarës (Jugosllavi), ku kreu shkollën normale dhe studioi për muzikë.

Punoi si mësues muzike dhe dirigjent. Shkrimet i botoi në organet letrare të Kosovës. Botoi vëllimin

"Tregime arbënore", përmbledhjet poetike "Agimet dhe parambramjet e Arbëneshtit" dhe "E vërteta" me temë nga jeta e arbëreshëve të Zarës. Shkrimet e tij shquhen nga notat romantike dhe thjeshtësia e shprehjes. Hartoi këngë dhe operën me temë patriotike "Vana".

FOTO E HERESHËM E FAMILJES DESHPALI : SHIME (BABAI)
DHE FËMIJTË: MAJA DHE PAULI, VIOLINË,
VALTERI ME VIOLONÇELLO.

VIZITË HISTORIKE E ZAEVIT NË PRISHTINË

PA DOREZA ME KOSOVËN



Zaev gjithashtu ka theksuar se me kryeministrin e Kosovës, Haradinaj, kanë biseduar për projektet e përbashkëta, për avancimin e komunikimit ndërmjet dy shteteve, Kosovës dhe Maqedonisë. Ndërkaq, kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosovën dhe Maqedoninë i lidh orientimi euroatlantik i të dyja vendeve

Prishtinë, 12 dhjetor - Republika e Maqedonisë dhe Republika e Kosovës kanë marrëdhënie dhe bashkëpunim pozitiv dhe konstruktiv në të gjitha nivelet, pa çështje të hapura. Vizita në Kosovë është një mundësi për thellimin e marrëdhënieve të mira. Kështu tha dje në Prishtinë, kryeministri Zoran Zaev, i cili bëri një vizitë zyrtare në Prishtinë, ndërsa u takua me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, presidentin Hashim Thaçi dhe kryeparlamentarin e Kosovës, Kadri Veseli. "Me kryeministrin Haradinaj dhe me ministrat e tjerë në Qeverinë e Kosovës, me kryetarin e Parlamentit të Kosovës, Kadri Veseli dhe presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, takohemi si udhëheqës të dy vendeve pa çështje të hapura. Ne jemi këtu për të hedhur një hap më tej: të hapim mundësi të reja për përmirësimin e mëtejshëm dhe thellimin e marrëdhënieve tona reciproke. Jam i lumtur që jam kryeministri i parë i Republikës së Maqedonisë, i cili erdhi për të vizituar Kosovën", tha Zaev. Kryetari i Qeverisë së Maqedonisë ndërkohe me nderime shtetërore u prit para Qeverisë së Kosovës nga kryeministri kosovar Ramush Haradinaj. Zaev gjithashtu ka theksuar se me kryeministrin e Kosovës, Haradinaj, kanë biseduar për projektet e përbashkëta, për avancimin e komunikimit ndërmjet dy shteteve, Kosovës dhe Maqedonisë. Ndërkaq, kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosovën dhe Maqedoninë i lidh orientimi euroatlantik i të dyja vendeve. "Në këtë vizitë të sotme kemi mundur të ndihmojmë që marrëdhëniet tona, pra, ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë të përparojnë. Ato janë të mira, por të përparojnë. Sot kemi marrë plot obligime që besoj se do të kemi rastin t'i finalizojmë në të



Kryeparlamentari Veseli ka rikujtuar se Kosova është në përfundim e sipër të autostradës "Arbën Xhaferi" e cila lidh Prishtinën dhe Shkupin, e cila do ta lehtësojë komunikimin e qytetarëve dhe shkëmbimet tregtare

ardhmen edhe në takime të përbashkëta të dy qeverive, pra, të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, në interes të qytetarëve të dy vendeve tona", ka thënë kryeministri Haradinaj. Në takimin e përbashkët është cekur se do të intensifikohet puna e Komitetit të përzier për zbatimin e Marrëveshjes për hapje të vendkalimit kufitar Bellanoc-Stançiq. "Kryeministrin Haradinaj i transmetova se në shtëpi, në Republikën e Maqedonisë, ndër-

morëm obligime për t'i përmbushur kriteret në mënyrë që të dëshmojmë se vendi ynë ka shoqëri demokratike dhe të pjekur. Kjo mbetet prioritet kulmor i qeverisë në Republikën e Maqedonisë. Njëkohësisht, kjo do të thotë se jemi të përkushtuar të ndërtojmë një shoqëri për të gjithë", u shpreh Zaevi, duke i bërë ftesë të hapur kryeministrin Haradinaj për vizitë kthyesë zyrtare në Republikën e Maqedonisë dhe e konfirmoi interesin për mbajtje të mbledhjes së përbashkët qeveritare, për të cilën shpresojmë se do të organizohet gjatë vitit 2018. "Në emër të qytetarëve, e posaçërisht të biznesmenëve në Republikën e Maqedonisë, gjatë takimit me kryeministrin Haradinaj e transmetova porosinë për intensifikim të bashkëpunimit ekonomik dhe rritje të vëllimit të këmbimit tregtar mes dy vendeve fqinje. U dakorduam se është e domosdoshme ta përmirësojmë infrastrukturën e cila na lidh. Nga ana jonë, shprehëm gatishmëri të vazhdojmë me ndërtimin e aksit të autostradës Bllacë-Shkup", thuhet në kumtesën nga Kabineti i Zaevit.

HETIM NDËRKOMBËTAR PËR KUMANOVËN

Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev në Prishtinë ka deklaruar se qytetarët duhet ta dinë të vërtetën lidhur me incidentin e armatosur në Kumanovë, i cili kishte ndodhur në maj të vitit 2015. Deklaratën e tillë kryeministri Zaev e

ka bërë pas takimit me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj. "Jemi pajtuar që të ketë qoftë edhe një hetim ndërkombëtar ose të dërgohen përfaqësues ekspertë, të cilët do t'i ballafaqojnë të gjitha elementet dhe provat. E gjithë kjo, me qëllim që t'iu jepen qytetarëve përgjigjet e vërteta. Kjo është edhe në interes të bashkëpunimit tonë. Nuk duhet që kjo çështje të mbetet si pengesë në marrëdhëniet tona. E dini se është çështje shumë e ndjeshme, sepse aty u vranë edhe disa policë. Pra, do të ketë një hetim ndërkombëtar, gjithmonë me qëllim që të arrihet deri tek e vërteta", ka thënë kryeministri Zaev. Në incidentin e armatosur në Kumanovë, më 9 dhe 10 maj të vitit 2015, u vranë 8 pjesëtarë të forcave policore dhe 10 pjesëtarë të grupit të armatosur, në të cilin ishin të përfshirë edhe shqiptarë nga Kosova.

VESELI I KUJTON ZAEVIT AUTOSTRADËN

Kryetari i Parlamentit të Kosovës, Kadri Veseli, në takim me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev diskutuan për raportet që Prishtina dhe Shkupi zyrtar kanë ndërtuar midis tyre në të gjitha nivelet e bashkëpunimit institucional dhe njëherësh vlerësuan se ky bashkëpunim ndërmjet dy vendeve, i shërben paqes, sigurisë dhe demokratizimit të rajonit. Ata theksuan se marrëdhëniet midis dy vendeve janë të mira, ndërsa shprehën përkushtimin që ba-

shkëpunimi ndërshtetëror të thellohet edhe më tej në të ardhmen, në frymën e orientimit të përbashkët euro-atlantik, si rrugë e vetme e të ardhmes së rajonit. Kryeparlamentari i Kosovës dhe kryeministri i Maqedonisë, konsideruan se Kosovën dhe Maqedoninë, si dy vende fqinje, të pavarura dhe sovraane, i bashkon shumëçka, prandaj theksuan nevojën e adresimit të sfidave të përbashkëta. Kryeparlamentari Veseli ka rikujtuar se Kosova është në përfundim e sipër të autostradës "Arbën Xhaferi" e cila lidh Prishtinën dhe Shkupin, e cila do ta lehtësojë komunikimin e qytetarëve dhe shkëmbimet tregtare. Nga ana e tij, edhe kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, u zotua se shumë shpejt qeveria e tij do të nisë pjesën e autostradës nga Shkupi deri në pikën kufitare me Kosovën. Ndryshe, gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, Zaevi u taku edhe me përfaqësuesit e komunitetit të biznesit maqedonas-kosovar. Në delegacionin që u udhëhoq nga kryeministri Zaev, i pranishëm ka qenë edhe ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski, ministri i Kulturës, Robert Alagjovovski, si dhe ministri pa portofol përgjegjës për Diasporën, Edmond Ademi. Vizita e Zaevit është vizita e parë zyrtare e një kryeministri të Republikës së Maqedonisë në Republikën e Kosovës. Vizita e Zaevit është e treta e një kryeministri të Maqedonisë në Kosovë që nga fundi i luftës. Lupço Georgievski e ka vizituar Kosovën menjëherë pas luftës, ndërsa Nikolla Gruevski në Prishtinë ishte para dhjetë vitesh, konkretisht më 5 maj 2007. Megjithatë, Zaev është i pari kryeministër nga Shkupi që vjen në Prishtinë që nga shpallja e Pavarësisë.

I LUMTUR QË JAM KRYEMINISTRI I PARË MAQEDONAS QË VIZITON KOSOVËN

Pas takimit me Haradinajn, Zaev ka shkruar në Facebook se dy vendet nuk kanë asnjë çështje të hapur. "Republika e Maqedonisë dhe Republika e Kosovës kanë marrëdhënie pozitive e konstruktive dhe bashkëpunim në të gjitha nivelet", ka thënë Zaev në një postim në

Facebook pas takimit me kryeministrin Haradinaj. "Jemi këtu për të shkruar një hap para: të hapim mundësi të reja për promovim dhe thellim të marrëdhënieve tona bilaterale. Jam i lumtur që jam kryeministri i parë i Republikës së Maqedonisë që viziton Kosovën", ka shkruar ai.

LIGJI PËR GJUHËT DHE AI PËR DËSHMITARËT E MBROJTUR ME PRIORITET



PAS BUXHETIT, ZHVILLIME DINAMIKE NË PARLAMENT

Ajo që do të merr vëmendjen e opinionit publik është kthimi i debatit mbi Ligjin për gjuhët, për shkakun se BDI dhe ASH insistojnë të mbetet drafti i njëjtë bazuar në marrëveshjen politike mes tyre dhe LSDM-së kur u arrit koalicioni qeveritar, ndërkaq kjo e fundit ka propozuar katër amendamente, me të cilët kërkon futjen në ligj edhe të gjuhëve të komuniteteve tjera

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 12 dhjetor - Pas mbarimit me debatin për Buxhetin për vitin 2018, dhe votimit të tij nga deputetët, në Parlament priten zhvillime dinamike sa i përket ngjarjeve politike dhe miratimit të një sërë ligjesh që prekin reformat në vend. Diskutabile mbetet rikthimi i deputetëve të VMRO-së në seancat plenare edhe në komisione, meqë pas heqjes së imunitetit të gjashtë deputetëve të kësaj partie, VMRO ka paralajmëruar braktisjen e Parlamentit, por që endet nuk ka një qëndrim përfundimtar. Kjo më shumë lidhet me zhvillimet rreth dorëheqjes së liderit të VMRO-së, Nikolla Gruevski, ku të dielën pasdite përfundimisht lëshoi karrigen e të parit të VMRO-së. Ajo që do të merr vëmendjen e opinionit publik është kthimi i debatit mbi Ligjin për gjuhët, për shkakun se BDI insiston të mbetet drafti i njëjtë bazuar në marrëveshjen politike me LSDM-në kur u arrit koalicioni qeveritar, ndërkaq kjo e fundit ka propozuar katër amendamente me të cilët kërkohet futja e gjuhëve të komuniteteve tjera në nenin 2 paragrafin 4 dhe uljen dënimeve për institucionet që refuzojnë të zbatojnë këtë ligj nga 4 deri në 5 mijë euro në 1 mijë deri në 2 mijë

euro. Amendamente kanë propozuar edhe Lëvizja BESA që kanë të bëjnë me emërtimin e Ligjit, ku kërkojnë që të quhet "Ligji për gjuhë shqipe" jo siç është propozuar tani "Ligji për gjuhët". Ndërsa VMRO ka propozuar amendamente me theks tek heqja e gjuhës shqipe si gjuhë e dytë zyrtare, por kjo të zëvendësohet me përkthimin gjuhën shqipe të shkresave zyrtare në të gjitha organet e pushtetit qendror. Ligj tjetër që po ashtu do të tërheq vëmendjen e opinionit është edhe Ligji për dëshmitarët e mbrojtur, gjegjësisht lejimi i Prokurorisë Speciale Publike të caktojë vetë dëshmitarët e mbrojtur pa dënimin dhe lejen e Prokurorisë Publike. Pas votimit të Buxhetit, presidenti Gjorge Ivanov do të mbajë fjalim vjetor

para deputetëve, ndërsa pritet po ashtu të votohet kryeprokurori publik shtetëror, dhe të votohet për emrat e rinj në dikasteret qeveritare, atë të Shëndetësisë, ministrit pa resor që mbulon investimet e huaja në vend, dhe postin e zëvendësministrit të Arsimit. Pas Vitit të Ri, paralelisht me bisedimet për zgjidhjen e çështjes së emrit me Greqinë, do të vazhdojnë reformat në gjyqësor dhe në shërbimin inteligjent përmes ndryshimit të ligjeve që prekin punën e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërbulim dhe të Agjencisë për Zbulim. Me theks të veçantë do të jetë e heqja e kompetencave të DSK-së për të përgjuar dhe kjo të kalohet tek vetë Prokuroria Publike, ndërsa DSK vetëm do të zbatojë vendi-

met e PP-së se kush duhet të përgjohet përmes ndjekjes së komunikimeve elektronike. Sfidë për Qeverinë re do të jetë edhe Regjistrimi i popullsisë dhe reformat për sistemin zgjedhor. Mbetet të shihet nëse në vitin 2018 për shkak të bisedimeve për emrin dhe anëtarësimin të mundshëm të Maqedonisë në NATO të shtyhet edhe më tej Regjistri i popullsisë. Siç dihet, Maqedonia është i vetmi vend në Evropë që për 15 vite nuk ka regjistruar popullsinë dhe ekonominë familjare. Në lidhje me reformat në sistemin zgjedhor, LSDM si partia më madhe në pushtet tani -sa ishte në opozitë kërkonte që Maqedonia të jetë një Njësi zgjedhore e jo në gjashtë sa është që nga viti 2002.

SOT DEBATI PËR AMENDAMENTET E SHQIPES

Seanca e Komisionit për Çështje Evropiane në të cilën në rend dite është debati për amendamentet për Propozim-ligjin për gjuhët do të mbahet sot (e mërkurë), konfirmoi për MIA-n kryetari i Komisionit, Artan Grubi. Sot është dita e tretë dhe e fundit për shqyrtimin e 90 amendamenteve të dorëzuara nga LSDM-ja, VMRO-DPMNE-ja dhe Besa për Propozim-ligjin për gjuhët. Komisioni të hënën e miratoi rendin e ditës me ç'rast u anulua për shkak të mospjesëmarrjes së përfaqësuesve të Ministrisë

së Drejtësisë, si përfaqësues të Qeverisë. Me miratimin e rendit të ditës filluan të vijnë edhe afatet treditore për debatin për amendamentet. Grubi pohoi se edhe pse afatet po vijnë, po respektohen dhe se nuk bëhet fjalë për keqpërdorim të Rregullores. Pritjet e tij janë se deputetët e VMRO-DPMNE-së dhe koalicionit do të vijnë në vazhdimin e nesërm, se do t'i mbrojnë amendamentet e tyre dhe se ata do të votojnë për ligjin. Grubi konsideron se ligji do të miratohet deri në festat e Vitit të Ri.

Të shfrytëzohen zhvillimet pozitive për t'u integruar në NATO

Shkup, 12 dhjetor - Sfidat aktuale të sigurisë në rajon si dhe përvojat e ARM-së në sferën e operacioneve ndërkombëtare nga NATO kanë qenë tema të bisedimeve midis shefit të shtatmadhorisë së ARM-së, gjeneral nënkolonel Metodija Veliçkovski dhe drejtorit të Qendrës për Fondacionin për Politikë të Jashtme "Dallas dhe Sara alison", Luk Kofi. Delegacioni i ARM-së i kryesuar nga Veliçkovski në kuadër të vizitës së punës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë ditës së djeshme realizoi vizitë në fondacionin "Heritixh". Siç informojnë nga ARM, drejtori Kofi ka theksuar se Maqedonia duhet ta shfrytëzojë këtë zhvillim pozitiv të ngjarjeve për integrimin sa më të shpejtë të vendit tonë në NATO me ç'rast e ka mbështetjen pa rezervë të fondacionit. Duke e pasur parasysh ndikimin e fondacionit "Heritixh" i cili deri më tani e ka pasur në sjelljen e vendimeve të rëndësishme tek udhëheqësia politike e SHBA-së, qëndrimi i shprehur për momentin e ka rëndësinë e vet. Në selinë e Ambasadës së RM-së në SHBA nga Shoqata e Diasporës së Bashkuar të Maqedonisë (DBM) shefit të SHM të ARM-së i është dorëzuar "Çmimi i DBM për merita në shërbim dhe shërbimin publik", ndërsa komandantit të Gardës nacionale të Vermontit, gjeneral majorit Krej çmimi për merita dhe kontribut në partneritet. Gjenerali Krej e ka theksuar rëndësinë e programit për partneritet dhe bashkëpunim të SHBA-së me Maqedoninë, duke shtuar se ky bashkëpunim do të vazhdojë të zhvillohet dhe të jetë shtylla kryesore e partneritetit dhe arritja e sukseseve të mëtejme.

PËRFUNDON TAKIMI I PARË I NEGOCIATORËVE

Emri mund të zgjidhet vitin e ardhshëm

Bruksel, 12 dhjetor - Çështja për emrin mund të zgjidhet vitin e ardhshëm, deklaroi ndërmjetësi Methju Nimic pas bisedimeve të martën në Bruksel me përfaqësues të Maqedonisë dhe të Greqisë, Vasko Naumovski dhe Ademantios Vasilakis, transmeton MIA. "Pas kaq viteve, nuk do të paraqitet emër i ri magjik. Zgjidhja do të gjendet me vullnet politik dhe diplomaci të mirë", tha Nimic. Sipas ndërmjetësit, përfundimisht edhe në Greqi edhe në Maqedoni



doni është përmirësuar klima për çështjen e emrit. Nimici nuk tregoi nëse në takim ka dalë me pro-

pozim të ri. Raundi i djeshëm i bisedimeve për emrin në Bruksel u mbajt pas pushimit prej tre vjetëve. Në ndërkohë, televizioni grek "Star" kumtoi se "Maqedonia e Re" është propozimi për të cilin do të bisedohet në Bruksel në takimin e ndërmjetësit Methju Nimic me përfaqësuesit e Maqedonisë dhe Greqisë. Në materialin e publikuar në lajmet qendrore të televizionit, ceket se nëse Shkupi dakordohet me këtë propozim, do të hapet rruga për zgjidhjen e çështjes së emrit në gjysmën e parë të vitit 2018, siç paralajmëruan edhe kryeministri Aleksis Cipras dhe shefi i diplomacisë, Nikos Koxias. "Star" thekson se propozimi fillestar grek ka qenë "Maqedonia e Vardarit", por tani ka ardhur deri te propozimi "Maqedonia e Re", siç ishte në vitin 1992 në pakon e ashtuquajtur "Pineiro", që atëherë ishte refuzuar. Emri me përcaktim gjeografik si "Maqedonia Veriore" nuk është i pranueshëm për palën greke, sepse,

siç ceket, nuk do ta parandalonte irredentizmin e Shkupit dhe implikon ekzistimin edhe të Maqedonisë Jugore, që nuk është e pranueshme edhe për Bullgarinë. Më pas përkujtohet deklarata e Ciprasit për "Star" e dhënë pas marrjes së pushtetit, ku thotë se Greqia ka gabuar që para 20 viteve nuk e ka pranuar pakon "Pineiro" e cila parashihte emër të përbërë me përcaktim gjeografik, që sipas tij, do të ishte zgjidhje e mirë për kontestin.

DORËHIQEN JAKUPI, PREKOPUCA, UZUNOV, BONEVA DHE SËRCEV

DORËZOHEN ANËTARËT E KSHZ-së

Koha pas dorëheqjes së kryetarit të Komisionit Shtetëror Zgjedhor Aleksandër Çiçakovski dhe anëtarët që përfaqësojnë LSDM-në Igor Milev dhe Violeta Duma, të martën ka dhënë dorëheqje anëtari shumëvjeçar i KSHZ-së që përfaqëson BDI-në Subhi Jakupi, nënkryetari nga radhët e ekspertëve Rexhep Prekopuca dhe anëtari tjetër nga radhët e ekspertëve Atanas Uzunov, si dhe dy anëtarët e VMRO-së, Silvana Boneva dhe Sasho Sërcev

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 12 dhjetor - Në Komisionin Shtetëror Zgjedhor vazhdojnë dorëheqjet e njëpasnjëshme pas presionit të opinionit publik lidhur me nëntë rrogat shtesë që anëtarët e KSHZ-së i ndanë kohë më parë për vete. Pas dorëheqjes së kryetarit të KSHZ-së, Aleksandër Çiçakovski dhe anëtarët që përfaqësojnë LSDM-në, Igor Milev dhe Violeta Duma, të martën dorëheqje kanë dhënë anëtari shumëvjeçar i KSHZ-së që përfaqëson BDI-në, Subhi Jakupi, nënkryetari nga radhët e ekspertëve, Rexhep Prekopuca dhe anëtari tjetër nga radhët e ekspertëve - Atanas Uzunov. Dorëheqje kanë dhënë edhe dy anëtarët që përfaqësojnë VMRO-në, Silvana Boneva dhe Sasho Sërcev, ndërsa Ermira Asani Salija që përfaqëson Lëvizjen BESA në KSHZ - ka refuzuar të japë dorëheqje duke u arsyetuar se ajo nuk ka marrë pjesë në votim për bonuset shtesë. Në arsyetimin për dorëheqjen e tij, Subhi Jakupi tregon faktin se edhe herët tjera - ai bashkë me kolegët e tij kanë shpërblyer veten me rroga shtesë, por siç thotë ai, vendimi i fundit ishte më alarmant që kanë marrë deri më tani. "Unë dua t'iu tregoj se sot do të deponoj dorëheqjen time për shkakë etike të jotransparencës për vendimin në lidhje me bonuset. Ne kemi sjellë edhe vendime të tjera, por ky ishte më alarmant, ndoshta jo për fajin tim personal, por edhe për faj të udhëheqësisë. Do të jetë më e ndershme që edhe unë të bëj të njëjtën gjë", ka thënë për mediat Subhi Jakupi. Ai shpjegoi edhe procedurën e zëvendësimit të tij dhe kolegëve tjerë për pushimin e mandati të KSHZ-së. "Pasi të konstatohet dorëheqja jonë nga Parla-



menti, prej asaj dite ne na hiqen mandatet. Parlamenti duhet të hapë konkurs të veçantë prej tetë ditësh, ku do të kenë të drejtë konkurrimi ata të cilët i plotësojnë kriteret e vendosura për postet përkatëse", ka deklaruar Jakupi. Nga ana tjetër, anëtarja e KSHZ-së që përfaqëson Lëvizjen BESA, Ermira Asani-Salija ka thënë për mediat se ajo nuk do të japë dorëheqje ndërkaq është arsyetuar se në momentin kur KSHZ ka marrë një vendim të tillë, ajo ka qenë në pushim. "Nuk do të japë dorëheqje pasi gjatë kohës kur është marrë vendimi për bonuset, unë kam qenë në pushim dhe një javë s'kam qenë në punë. Unë nuk kam votuar për ato bonuse, për atë, nëse tani jap dorëheqje - i vjen sikur ta pranoj fajin të cilin të tjerët e kanë bërë", ka thënë Asani-Salija. Ajo ka shtuar se nuk ndjen përgjegjësi morale për të marrë përsipër, siç ka thënë, turpin e korrupsionit eventual në KSHZ.

STANDARDET E DYFISHTA TË KSHZ-SË

E njëjta është zotuar se paratë e lëshuara në llogarinë e saj bankare do ti kthejë në momentin që Qeveria të marrë vendim për këtë çështje. Njëkohësisht, Ermira Asani-Salija është ankuar për standarde të dyfishta në KSHZ lidhur me harxhimet për rrugën. "Derisa jam aty, nuk më janë paguar as harxhimet e rrugës që më takojnë me ligj. Dikush ka veturë zyrtare dhe kartelë, ndërkaq dikush s'ka të drejtë ta marrë edhe atë që i takon", ka thënë Ermira Asani-Salija për Portalb. Sipas informatave që kanë dalë në media, Ermira Asanit-Salija i janë ndarë dy rroga shtesë, ndërsa shtatë rrogat tjera janë ndarë për ish anëtarin e KSHZ-së, Bedredin Ibrahim. I pari që bëri publik për opinionin e gjerë bonuset prej nëntë rrogave shtesë të anëtarëve të KSHZ, ishte ambasadori i SHBA-ve, Xhes Bejli. "Kam dëgjuar

që anëtarët e KSHZ i kanë dhënë vetës rrogë shtesë për katër muaj të plotë për punën e tyre për zgjedhjet lokale në tetor. Ato më parë rrogë shtesë kanë marrë edhe për pesë muaj pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016. Votimi në Komision ka qenë i njëzëshëm, të gjitha partitë, të gjitha etnikumet, ndërsa personeli i komisionit ka fituar më pak bonus. Unë jam nëpunës publik dhe e mbështet shpërblimin e nëpunësve publik që punojnë më shumë nga e parashikuara, por kam një pyetje në lidhje me këtë: KSHZ a është trup i pavarur?. Ndoshta masa ishte edhe ligjore, por votimi u bë pas dyerve të mbyllura", u shpreh javë më parë ambasadori Bejli gjatë një ligjërate kushtuar luftës kundër korrupsionit në Fakultetin e Sigurisë në Shkup. Pas këtij reagimi, anëtarët e KSHZ-së vendosën unanimisht që vendimin për rrogat shtesë ta publikojnë në faqen elektronike të këtij institucioni. Siç dihet, anëtarët e KSHZ-së marrin pagë mujore prej 68 mijë denarëve, e që i bie se çdo anëtar ka marrë bonus mbi dhjetë mijë euro. Por, anëtarët e KSHZ-së marrin të holla sikur deputetët edhe për harxhimet e rrugës. Zakonisht, disa prej tyre edhe pse dihet se jetojnë në Shkup, por jo me dokumente, vendbanimin e kanë të lajmëruar nga qytetet prej nga vijnë, dhe për harxhimet e rrugës kanë marrë deri në 100 euro në ditë. Muaj më parë plasi skandali nga mediat me harxhimet marramendëse për rrugë të anëtares së KSHZ-së, Silvana Boneva, që përfaqëson VMRO-në, ku për një ditë ka deklaruar se ka harxhuar deri në 9700 denarë. Anëtari nga radhët e ekspertëve, Atanas Uzunov, ka deklaruar harxhime ujore për rrugë deri në 1500 euro. Anëtarët e KSHZ-së po ashtu kanë harxhuar edhe rreth 30 mijë euro për reprezentim, ushqim dhe pije.

ERMIRA ASANI SALIJA

Nuk do të japë dorëheqje pasi gjatë kohës kur është marrë vendimi për bonuset, unë kam qenë në pushim dhe një javë s'kam qenë në punë. Unë nuk kam votuar për ato bonuse, për atë, nëse tani jap dorëheqje - i vjen sikur ta pranoj fajin të cilin të tjerët e kanë bërë. Dhe derisa jam aty, nuk më janë paguar as harxhimet e rrugës që më takojnë me ligj. Dikush ka veturë zyrtare dhe kartelë, ndërkaq dikush s'ka të drejtë ta marrë edhe atë që i takon

HARROHET PASTRIMI I LISTËS ZGJEDHORE

Por kur bëhet fjalë për bonuse të aparatit administrativ dhe ekspertëve të angazhuar, siç ishte rasti me ekspertë që bënë kryqëzimin e të dhënave, anëtarët e KSHZ-së i kanë ndarë vetëm 10 mijë denarë secilit. Vetëm për vitin 2016, anëtarët KSHZ për reprezentim kanë harxhuar mbi 30 mijë euro. Në bazë të ndryshime të Kodit Zgjedhor të vitit 2014, gjegjësisht të nenit 19 të tij, kryetari dhe anëtarët e organeve zgjedhore dhe administrata zgjedhore kanë të drejtë kompensimi i cili përcaktohet nga një akt i miratuar nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor. Ndërkaq, këtë të drejtë e kishin vetëm punonjësit e KSHZ-së edhe atë që nga viti 2006. Edhe përkundër presionit të opinionit publik që të kthehen paratë e KSHZ-së, më 5 dhjetor vendosi që ato të mos kthehen. Kjo bëri që presioni të rritet dhe të vijë deri tek dorëheqja e shtatë anëtarëve të KSHZ-së: Subhi Jakupi, Violeta Duma, Igor Milev, Rexhep Prekopuca dhe Atana Uzunov, Silvana Boneva dhe Sasho Sërcev. Ndryshe KSHZ, nga shtatë anëtarët sa kishte vite me radhë, më 2015-ën u shtua me dy anëtarë të tjerë, ndërsa ndryshoi edhe organika e përfaqësimit politik. Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor që erdhën si rezultat i bisedimeve të Marrëveshjes së Përzahinos, tre anëtarë do të jenë nga radhët e ekspertëve, dhe dy prej tyre do të jetë kryetar dhe nënkryetar, ndërsa par-

titë më të mëdha parlamentare do të kenë nga dy përfaqësues, derisa partia e dytë më e madhe opozitare një përfaqësues. Ndonëse u fol shumë për Listë zgjedhorë të fryrë me shifra të mëdha të votuesve fiktiv, pas kryqëzimit të të dhënave dhe pas një procesi të gjatë të verifikimit të të gjithë votuesve, KSHZ nuk arriti të pastrojë në tërësi Listën zgjedhore. Në opinion ende ka dyshime për dhënien e letërnjoftimeve fantom, por që sipas asaj që kanë deklaruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, kjo ministri dhe Qeveria a re po punon vazhdimisht në drejtim të pastrimit të Listës zgjedhore, por deri më tani nuk ka ndonjë rezultat pozitiv. Mbi 30 mijë votues që më kërkesën e LSDM-së u hoqën për zgjedhjet parlamentare, të njëjtit u kthyen dhe nuk u kontestuan nga ajo për zgjedhjet lokale. Për KSHZ-në, është folur mjaft, por partitë politike edhe përkundër zgjerimit të saj përsëri nuk i mundësuan kompetencën të administrojnë me Listën zgjedhore duke vazhduar të jetë e varur me të dhënat që u dërgon Ministria e Punëve të Brendshme. Anëtarëve të rinj KSHZ ashtu si të vjetërve nuk iu dëgjua zëri të hulumtojnë raste për votuesit fiktiv, ndërsa nuk ndër vite nuk e kanë zgjeruar as aparatit administrativ. Se ai që është aktualisht nuk mjafton u pa edhe në viti 2015 kur edhe u bë kryqëzimi i të dhënave kur u deshtë të marrin ekspertë nga jashtë nga lëmia e informatikës.

Për mbrojtje sociale, punësime dhe pensione 43.37 miliardë denarë

Shkup, 12 dhjetor - Qeveria me 43.37 miliardë denarë në vitin 2018 do t'i përmirësojë gjendjet në sferën e punës dhe mbrojtjes sociale, mbrojtjen e fëmijëve, inkluzionin e grupeve të ndjeshme të qytetarëve, deinstitutionalizimin e institucioneve për kujdes, ndërkaq do të mundësojë edhe harmonizim ligjor të pensioneve dhe pagesë të tyre të rregullt dhe me kohë dhe do të punojë në uljen e papunësisë. "Propozim buxheti i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për vitin 2018 ka vlerë më të lartë, në krahasim me të gjithë resorët sepse pjesa më e madhe e mjeteve shkojnë drejtpërdrejt tek qytetarët, tha në konferencën e sotme për shtyp ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska. Shtoi se rritje më të madhe të mjeteve ka në sferën e mbrojtjes së fëmijëve për shkak të gjendjeve të konstatuara katastrofike, ndërkaq me qëllim të rritjes së përfshirjes së fëmijëve dhe përmirësimin e kapaciteteve hapësinore dhe kadrovike për kujdes të fëmijëve. Për këtë dedikim janë paraparë 1.578.290.000 denarë. Për ndërtimin dhe pajisjen e kopshteve të fëmijëve dhe objekteve për mbrojtje sociale janë planifikuar 58 milionë denarë. Carovska informoi se tetë miliardë denarë janë dedikuar për transferata sociale për mbi 120 mijë qytetarë shfrytëzues të kompensimeve sociale. Në buxhetin për vitin e ardhshëm janë planifikuar edhe mjete për masa aktive për punësim dhe atë në shumë prej 287.500.000 denarëve, ndërsa për transformim të institucioneve të mëdha për kujdesje, të cilët nuk i respektojnë të drejtat e njeriut në lartësi prej 25.713.000 denarëve. Një pjesë e madhe e buxhetit apo 29 miliardë e 158 milionë denarë janë për stabilitet, pagesë të rregullt të pensioneve dhe harmonizim të rregullt të pensioneve. Ministrja Carovska potencoi edhe se janë shkurtuar shpenzimet joracionale dhe se janë pakësuar apo hequr kompensimet për anëtarësim në komisione apo grupe të punës.

KUARTALI I TRETË ME RITJE TË BPV PREJ 0.2 PËR QIND



Kjo, sipas ekspertëve, tregon qartë për praktikën e këqija ekonomike të Qeverisë së mëparshme, ndërkohë që shifra prej 0.2 për qind e rritjes së BPV-së në kuartalin e tretë, është rritje reale ekonomike e jo si shifrat që i frynte Qeveria paraprake

VITI 2017,

VITI MË I KEQ EKONOMIK

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 12 dhjetor - Në vitin 2017, përkatësisht në 9 muajt e parë zhvillimi ekonomik, më në fund po lëviz nga zona negative. Kështu e vlerësojnë ekspertët ekonomik raportin e fundit zyrtar të Entit Shtetëror të Statistikës. Për periudhën qershor deri në fund të muajit shtator Bruto Prodhimi Vendor (BPV) është rritur vetëm 0.2 për qind. Kjo, sipas ekspertëve, tregon qartë për praktikën e këqija ekonomike të Qeverisë së mëparshme, ndërkohë që shifra prej 0.2 për qind e rritjes së BPV-së në kuartalin e tretë, është rritje reale ekonomike e jo si shifrat që i frynte Qeveria paraprake. Sipas Fatmir Bytyqit, ekspert ekonomik, edhe pse rritja e BPV-së prej 0.2 për qind është tepër e ulët, jep një optimizëm se Maqedonia po lëviz drejtë përmirësimit të gjendjes ekonomike në përgjithësi. "Vitin 2017, si duket do ta përfundojmë si një nga vi-

tet më të këqija në historinë e Maqedonisë, me rritje të mundshme prej 0.5 për qind dhe me këtë duhet të jemi të lumtur. Vlerësoj se viti 2018, duke i parë masat qeveritare si dhe tendencat e institucioneve ndërkombëtare financiare, do të duhej të japë njëfarë optimizmi në afat të mesëm se Maqedonia do të lëvizë në drejtim të përmirësimit të gjendjes ekonomike, gjë që të gjithë e duam. Vetëm shifrat reale për rritje ekonomike mund sjellin të mira për të gjithë qytetarët", thotë Bytyqi. Ndërsa sa i përket parashikimeve të Qeverisë së re se deri në fund të mandatin katërvjeçar rritja ekonomike do të shkon në 5 për qind, Bytyqi vlerëson mund të jetë parashikim i realët, nëse gjatë tre viteve të ardhshme do të kemi rritje në ekonominë e vendit.

Për profesorin e ekonomisë, Marjan Petreski, të dhënat e fundit të ESHS-së se rritja ekonomike e BPV-së në kuartalin e

tretë është 0.2 për qind, paraqet një tregues të realët se ekonomia e Maqedonisë po lëviz nga zona negative zero. "Gjurmët e krizës politike, si duket u ndjenë edhe në kuartalin e tretë të këtij vit sa i përket rritjes së BPV-së. Mirëpo, me formimin e Qeverisë së re, u paraqit një dozë optimizmi për lëshim të butë të frenave ndaj biznesit, i cili vite me radhë ishte nën kthetrat e Qeverisë paraprake.

Të dhënat statistikore se si ka lëvizur rritja e BPV-së gjatë nëntë muajve të parë, janë tregues të qartë se që Maqedonia të zhvillohet ekonomikisht, nevojitet më shumë kohë që të kthehet në realitetin e rritjes ekonomike, aq më tepër kur bruto investimet edhe më tej po shënojnë ulje, ndërsa rritja e eksportit është ngadalësuar", thotë Petreski. Të dhënat e fundit të ESHS-së tregojnë se në tremujorin e parë të vitit 2017, BPV ishte në nivel të zeros, ndërsa në tremujorin e dytë u vërejt rënie prej

1.8%, dhe tani në tremujorin e tretë të këtij viti BPV-ja shënon rritje prej 0.2 për qind. Rritja prej 0.2 për qind e BPV-së, sipas ESHS-së është si shkak i rritjes në sektorin e tregtisë, transportit dhe bujqësisë, ndërsa rënie është shënuar në sektorin e ndërtimitarisë, xehetarisë dhe industrisë së përpunimit. Në kuartalin e tretë për rritje ekonomike ndikim më të madh kanë pasur amvisëritë që morën pjesë në strukturën e BPV-së me 65 për qind. Ekonomistët sugjerojnë që Qeveria të përmirëson projektimet për rritje të BPV-së prej 2.2 për qind deri në fund të këtij viti.

"Teknikisht nuk jemi në recesion. Është më se e qartë se viti 2017 do të përfundojë me rritje më të vogël se sa projektimet që parashihen nga Qeveria, gjegjësisht rritja totale e BPV-së deri në fund të këtij viti do të jetë pak mbi zero", thotë Marjan Petreski, profesor i ekonomisë në Kolegjin Amerikan në Shkup.

NDALOHEN 1435 AUTOMJETE ME REGJISTRIM TË SKADUAR

Tetovë, 12 dhjetor - Në rajonin e Tetovës dhe Gostivarit të hënën është zbatuar edhe një aksion kontrollin që në fokus ka pasur shpejtësinë e lëvizjes së automjeteve, në të cilin aksion gjithsej janë zbuluar 28 kundërvajtje në Tetovë 20 dhe 8 në Gostivar. Këto dhe kundërvajtje të tjera, si drejtim i automjeteve pa leje për vozitje, regjistrim i skaduar i automjetit, parkim në mënyrë të parregullt, vozitës fillestarë dhe të tjera janë sanksionuar me 28 sanksione adekuate për kundërvajtje si dhe me 41 fletëpagesa për gjobë,

me vërejtjen se gjoba për vozitje të shpejtë të automjetit lëviz nga 20 deri në 400 euro në kundërvlerë të denarit, varësisht nga tejkalimi i shpejtësisë së lejuar, vendit se ku është kryer kundërvajtja, në ose jashtë vendbanimit. Përndryshe shpejtësia edhe këtë vit është një ndër shkaqet e numrit më të madh të aksidenteve të komunikacionit të cilat kanë ndodhur në rajonin e Tetovës dhe Gostivarit, rajon ky që mbulon Sektorin për punë të brendshme në Tetovë, njoftojnë nga policia e Tetovës. Sipas policisë edhe përkundër

kontrolleve të shumta preventive, masave dhe aktiviteteve të tjera, të cilat në vazhdimësi i ndërmerr Sektorin për Punë të Brendshme në Tetovë, në rajonin më të gjerë të Tetovës, edhe më tutje është shumë i madh numri i personave të cilët drejtojnë automjete pa leje për vozitje, por edhe i atyre të cilët nuk i regjistrojnë automjetet në kohë. "Në 11 muajt e kaluar të këtij viti janë zbuluar gjithsej 1784 persona, të cilët nuk kanë pasur leje për vozitje, nga të cilët 180 vetëm në muajin nëntor. Përveç kësaj, gjitha-

shtu janë zbuluar edhe 1435 automjete me regjistrim të skaduar. Numri më i madh i vozitësve të egër të zbuluar kanë drejtuar vetura, por edhe furgonë, kamionë si dhe minibusë. Kryesisht bëhet fjalë për persona të moshës nga 16, 17 deri në 35 vjet, mes të cilëve jo rrallë herë ndalohen edhe personat e njëjtë të cilët përsërisin të njëjtën kundërvajtje. Ajo që më tepër është shqetësuese është fakti se mes pjesëmarrësve në aksidente komunikacioni me pasoja më serioze është shumë i madh numri i atyre që automjetet

kanë drejtuar pa leje për vozitje. Sektorin për Punë të Brendshme në Tetovë, edhe një herë rikujton se drejtimi i automjetit pa leje për vozitje është në kundërshtim me ligjin për siguri në komunikacion dhe rrugë, dhe se gjoba për këtë lloj kundërvajtjeje është 300 euro në kundërvlerë të denarit plus 400 euro për pronarin e automjetit të cilën ia ka dhënë për ta drejtuar një personi pa leje për vozitje. Gjoba për regjistrim të skaduar është nga 100 deri në 500 euro", njoftuan nga Policia e Tetovës.

KRONIKË

Arrestohet
i dënuari
për vjedhje

Pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, stacioni policor në Gostivar, të hënën rreth orës 10.00, kanë arrestuar 44-vjeçarit me iniciale V.S., i dënuar me një vit e gjysmë për veprën e kryer penale "vjedhje të rëndë". Pas arrestimit dhe mbajtjes së shkurtër në stacionin policor, të realizuar me urdhëresë gjyqësore V.S me pas është dorëzuar në burgun e Idrizovës në Shkup për të vuajtur dënimin me burg.

Mashtrojnë
mërgimtarin

55 vjeçari me iniciale Z.M nga fshati Çajllë i Gostivarit, të hënën rreth orës 17.00, ka denoncuar mashtrim kompjuterik deri më tani nga persona të panjohur. Duke shfrytëzuar adresën e tij elektronike dhe profilin e facebookut, një person apo disa persona të panjohur, nga dy shokët e Z.M-së, nga të cilët njëri i punësuar në Gjermani, kanë arritur që të marrin rreth 600 euro. Dy shokëve të Z.M-së i është prezantuar kinse është ai dhe se urgjentisht i nevojiten para. Kur njëri prej të mashtruarve i është paraqitur Z.M-së për të pyetur se ai ka marrë paratë e kërkuara, atij menjëherë i është bërë e ditur se bëhet fjalë për një mashtrim dhe rastin e ka paraqitur në polici. Po ndërmerren masa dhe aktivitete për zbardhjen e plotë të rastit të denoncuar si dhe për zbulimin e autorëve të këtij mashtrimi.

Aksident afër
Zhelinës, dy të
lënduar

Të hënën mbrëma, rreth orës 24.00, në rrugën regjionale që lidh fshatrat e Tetovës Zhelinën me Siriçinën, ka ndodhur një aksident komunikacioni, në të cilin janë përfshirë dy vetura me targa të Tetovës. Një veturë e tipit "Mazda", të cilën e ka drejtuar 52-vjeçari me iniciale I.R si dhe një tjetër veturë e tipit "Pezho 206", e drejtuar nga 21-vjeçari me iniciale F.Q nga Shemshova. Pas aksidentit që të dy vozitësit për pasojë kanë marrë lëndime trupore, dhe me anë të autoambulancës janë dërguar në spitalin klinik të Tetovës nga ku pas marrjes së ndihmës janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes dhe sipas njohurive fillestare që dalin nga ekspertiza e kryer në vendngjarje si shkak për këtë aksident ka qenë mos mbajtja e anës së lëvizjes, përderisa dëmi i shkaktuar material vlerësohet që të jetë rreth 100 mijë denarë.

KALLAJXHIEV JEP DORËHEQJE, PROBLEMET KRYESORE NUK JANË DETEKTUAR

LËKUNDET KËSHILLI
PËR REFORMA

Në arsyetimin e dorëheqjes së tij, profesori i të Drejtës procedurale penale, Kallajxhiev ka theksuar se ekzistojnë disa qendra të fuqishme të cilët procesin e reformave e realizojnë në mënyrë jo transparente

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 12 dhjetor - Këshilli për reforma në gjyqësor është trup mjaft i marginalizuar, shumë rrallë thirret dhe në rend të ditës shpeshherë janë vendosur çështje sipas përzgjedhjes së vet ministrisë. Këto kanë qenë disa prej arsyeve të cilat kanë ndikuar që profesori universitar, Gordan Kallajxhiev të japë dorëheqjen e tij nga pozita e anëtarit të Këshillit për reforma në gjyqësor, të cilin muaj më parë e formoi Ministria e Drejtësisë. Në arsyetimin e dorëheqjes së tij, profesori i të Drejtës procedurale penale, Kallajxhiev ka theksuar se ekzistojnë disa qendra të fuqishme të cilët procesin e reformave e realizojnë në mënyrë jo transparente. Pje-

sëmarrja në këtë Këshilli, siç ka njoftuar njohësi i mirë i problemeve në sistemin juridik në vend, ka qenë kryesisht në bazë të vullnetit të mirë, respektivisht sipas tij, nëse vullneti i mirë mungon edhe te pala tjetër, atëherë pjesëmarrja e tij në këtë Këshill nuk ka kuptim.

"Disa nisma të rëndësishme refuzohen pa asnjë argument. Kështu që unë, Këshillin e kam përjetuar më tepër si një dekor i Ministrisë dhe Qeverisë, sesa Këshill për reforma. Përkundrazi, mendoj se serioziteti i detyrës kërkon që të shqyrtojë mirë hapat që ndërmerren, për shkak se arnimi i dispozitave ligjore, nuk do të sjell zgjidhje të problemeve, ashtu siç nuk ndodhi deri më sot. Ne, edhe nëse nuk bëjmë reforma, kemi norma ligjore të mira. Por, realisht ne kemi probleme tjera serioze, të cilat de fakto ende nuk i kemi detektuar, të llojit pse dhe si sistemi jonë nuk është rezistues ndaj ndikimeve politike, cilat janë ato kanale përmes të cilëve bëhet presioni në gjyqësor dhe prokurorisë e që rezultojnë me politizim dhe selektim", ka thënë profesori, Gordan Kallajxhiev, duke sqaruar shkaqet për dorëheqjen e tij. Dinamika me të cilët i ka paramenduar të bëhen reformat në gjyqësor, pro-



GORDAN KALLAJXHIEV

Realisht ne kemi probleme tjera serioze, të cilat de fakto ende nuk i kemi detektuar, të llojit pse dhe si sistemi jonë nuk është rezistues ndaj ndikimeve politike, cilat janë ato kanale përmes të cilëve bëhet presioni në gjyqësor dhe prokurorisë e që rezultojnë me politizim dhe selektim

fesori Kallajxhiev, mes tjerash ka thënë se nuk janë zhvilluar në mënyrën të cilën ai e kishte vlerësuar. Mungesa e përfshirjes së vërtet të personave që para se gjithash janë të prekur nga këto reforma (gjykatësit, prokurorët, po edhe sektori civil) paraqet njëri prej shkaqeve që e ka shtyrë profesorin ta merr këtë vendim. Megjithatë, vërejtjet më të mëdha, të cilat kanë rezultuar me dorëheqjen e tij, ai i ka pasur

për punën e vetë Këshillit. Ndryshe, ai ka nënvizuar se i pranueshëm është argumenti i Qeverisë, se atyre ju duhet disa rezultate në periudhë të shkurtër për arritjen e disa qëllimeve politike. Megjithatë, profesori Kallajxhiev ka thënë se Qeveria duhet të jetë e qartë dhe të thotë se këto çështje do të rregullohen përmes procedurës së shkurtër. "Ndërsa, për shumë çështje tjera duhet të lihet më tepër hapësirë, të debatohet dhe të hulumtohet. Shumë reforma në botë bëhen mbi bazë të hulumtimeve disavjeçare. Për mua është e qartë se vetëm me plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve aktuale - ne asgjë nuk do të arrimë, respektivisht nëse kjo ishte problemi, atëherë ne disponojmë ne dispozita të mira ligjore", ka thënë Kallajxhiev. Këshilli për reforma në sistemin gjyqësor në Maqedoni, siç raportoi gazeta KOHA kohë më parë, nuk posedon autorizime ekzekutive, por qëllimi është që të funksionojë si një trup këshillëdhënës në kuadër të vet Ministrisë së Drejtësisë. Pjesë e këtij Këshilli edhe më tutje vazhdojnë të mbesin profesorët universitar, ndryshe kolegë të Gordan Kallajxhievit, mes të cilëve janë edhe Lubomir Ferçkovski, Borçe Davitkovski dhe Ana Pavlllova Daneva.

"Transmet" pamundëson qasjen e personit ekspert

Shkup, 12 dhjetor - Ekspertiza e kërkuar nga Prokuroria Speciale Publike, në rastin "Trust" është realizuar vetëm mbi dokumentacionin e kësaj kompanie, por jo edhe mbi gjendjen faktike të makinave për gërmimin e thëngjillit në Suvodoll të Manastirit. Kjo gjë u bë e ditur pasi të martën para Gjykatës Penale të Shkupit dëshmuar dy personat ekspert, të cilën javë më parë ishin të autorizuar nga gjykata që të kenë qasje në dokumentacionin e kompanisë "Transmet". Personi ekspert nga radhët e makinërisë, mes tjerash tregoi se me shkrësë ka

kërkuar nga kompania "Transmet", qasjen në makinat e tyre, mirëpo të njëjtit nuk i kanë lejuar. Për këto shkaqe, ai Prokurorinë Speciale Publike e ka njoftuar se ekspertizën e ka realizuar në bazë të dokumentacionit, dhe jo qasje direkte te makinat. Pala mbrojtëse e të akuzuarve, Sead Kočan, Vasilije Aviroviq dhe Safet Vatiq, kërkuar nga personi ekspert të tregojë se vallë ka realizuar ndonjëherë ekspertizë në sferën e xeheve apo gjeologjisë. Përgjigja e personit ekspert ishte negative, megjithatë ai shtoi se është i specializuar për ekspertizë të

makinave, respektivisht urdhri i PSP-së ka qenë ekspertiza ndaj mekanikës dhe jo lëndëve të para. Të akuzuarit në këtë lënë, sipas PSP-së, ngarkohen për falsifikim të dokumenteve për fitimin e tenderëve në Elektranat e Maqedonisë, në vlerë prej 17 milionë euro. Aktakuza e ngritur nga PSP, krahas dëshmimeve të ndryshme, ajo kryesisht mbështet në tre bisada që burojnë nga përgjimet e jashtëligjshëm, prej të cilave dy ende nuk janë publikuar në opinion, gjegjësisht të njëjtat së shpejti pritet të lëshohen në sallë e gjykatës. (O.XH)

Në raportin e ekspertit gjerman, Rainhard Priebe, është apostrofuuar se një pjesë e punonjësve në administratën shtetërore e kryejnë punën në mënyrë joefektive, njëherësh si vërejtje është apostrofuuar dhe instrumentalizimi i administratës për interesa të partive në pushtet, si dhe presionet vazhdueshme ndaj të punësuarve

TË ULET NUMRI I PUNONJËSVE SHTETËROR

S'KA REFORMA ME KËTË ADMINISTRATË

për një periudhë dhjetëvjeçare. Së pari, ndalimi, përkatësisht stopimi i punësimeve të reja në administratë; së dyti, sistematizimi i menjëherëshëm i nëpunësve të Sekretariatit; dhe së treti, digjitalizimi i shërbimeve administrative", vlerëson Argëtim Saliu, ekspert në këtë lëmi. Sipas tij, duhet kuptuar rëndësia e ndërprerjes së çdo punësimi në administratë, derisa të sistemohen në vende pune më shumë se një mijë administratorë shqiptarë, të punësuar në bazë të Marrëveshjes së Ohrit, të cilët marrin rrogë dhe qëndrojnë në shtëpi. Këto komente vijnë pasi ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski, tha se do të angazhohet

që përmes reformave, të profesionalizojë kuadrin e angazhuar në administratë, si dhe të shmangë influencën politike. Ai u zotua se asnjë administrator nuk do ta largojë nga puna pavarësisht se administrata në Maqedoni në vazhdimësi është kritikuar nga faktori ndërkombëtar për shkak të numrit të madh. "Nuk do të ketë shkarkime të administratës publike, por rristurimin e administratës publike do të përpqemi ta bëjmë që administrata të jetë më efikase dhe normalisht, më kryesore e reformave në administratë, është digjitalizimi i administratës", deklaroi Mançevski. Por, Borçe Davitkoski nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Shkupit për

Radion Evropa e Lirë thotë se pa u zvogëluar numri i të punësuarve në administratën publike, reformat nuk mund të rezultojnë me sukses, përkatësisht do të mbeten siç thotë ai, "në pikën zero", sepse një pjesë e konsiderueshme e të punësuarve në administratë përmes "çelësit" partiak nuk është produktive, por vetëm e shpenzon paratë nga arka e buxhetit për pagesën e rrogave të asaj pjese. "Nuk mund të bëhen reforma të mirëfillta pa u zvogëluar numri i të punësuarve në administratën publike. Duket qartazi se mungon vullneti politik për realizimin e reformave të mirëfillta në administratën publike, çdo pushtet ka frikë t'i largojë nga puna personat

joadekuatë në administratë, sepse fiton kundërshtarë politikë. Por, kjo ka kosto të lartë për shërbimet që marrin qytetarët nga administrata", konsideron Davitkoski. Nga ana tjetër, Tërpe Dejanovski nga Sindikata e të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor, thotë se është mirë që qeveria zotohet se nuk do të largojë askënd nga puna, megjithëse shton se duhet të skanohet gjendja e të punësuarve në administratë dhe të investohet në kualifikimin dhe profesionalizimin e shërbimeve që marrin qytetarët. "Mbase Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës duhet të bëjë një analizë të detajuar se cilat dikastere janë të mbingarkuara dhe në cilat ka nevojë për punësim, në mënyrë që asnjë i punësuar gjatë transferimit të mos dëmtohet sa i përket kategorizimit të vendit të punës". "Për ne është shumë e rëndësishme që asnjë nga të punësuarit në administratë gjatë ndryshimit të vendit të punës, të mos dëmtohet sa i përket kategorizimit të vendit të punës", thotë Dejanovski. Nga ana tjetër, në raportin e ekspertit gjerman, Rainhard Priebe, është apostrofuuar se një pjesë e punonjësve në administratën shtetërore e kryejnë punën në mënyrë joefektive, njëherësh si vërejtje është apostrofuuar dhe instrumentalizimi i administratës për interesa të partive në pushtet, si dhe presionet vazhdueshme ndaj të punësuarve në administratë. (REL)

Shkup, 12 dhjetor - Reformimi i administratës publike në Maqedoni, për të qenë një ekip i mirëfillt në shërbim të qytetarëve, sipas njohësve të këtij lëmi, duhet të bëhet në shumë dimensione, si dhe përmes një plani afatgjatë. Ata thonë se një reformim i tillë assesi nuk duhet shikuar si punë të përfunduar brenda një afati të shkurtër kohor, sa për të përmbushur një detyrim që i është përcaktuar Maqedonisë nga faktori ndërkombëtar. "Sfidat e reformimit të administratës publike në Republikën e Maqedonisë, do t'i kisha klasifikuar në tri segmente,

Publicitet

Në bazë të nenit 9 paragrafi (1) të Rregullores për procedurën dhe kriteret për shpërndarje të mjeteve për realizim të interesit publik në sport nr. 01-29/1 të datës 4.01.2017 në pajtim me Programin për zhvillim të sportit dhe të rinjve për vitin 2017 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 192/16), Programi për shpërndarje të mjeteve nga lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese për vitin 2017 për financimin e federatave nacionale të sportit dhe projekteve të Agjencisë për të rinj dhe sport për avancimin e sportit në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 192/16), si dhe Vendimit për publikim të Konkursit për vitin 2017 nr. 08-1845/1 të datës 07.11.2017, drejtori i Agjencisë për të rinj dhe sport e Republikës së Maqedonisë, publikon

KONKURS Për ndarje të mjeteve për vitin 2017

Publikohet konkurs për ndarje të mjeteve për vitin 2017, nga: Programi për shpërndarje të mjeteve nga lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese për vitin 2017 për financimin e federatave nacionale të sportit dhe projekteve të Agjencisë për të rinj dhe sport për avancimin e sportit në Republikën e Maqedonisë, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 192/16).

I. b

Numri rendor	Përcaktimi	Përshkrimi
2	Participim për financim të klubeve të të rinjve pjesëmarrës në sistemin nacional sportiv të garave të organizuara nga federatat nacionale sportive	Është planifikuar participim për mbështetje të sportistëve të rinj dhe klubeve pjesëmarrëse në sistemin nacional sportiv të garave në sporte ekipore dhe individuale të organizuara nga federatat nacionale sportive

Aplikacionet për pjesëmarrje në "Konkurs për ndarje të mjeteve për vitin 2017" merren nga internet faqja e Agjencisë për të rinj dhe sport www.ams.gov.mk ku është dhënë përshkrim i paragrafëve sipas të cilave do të udhëhiqeni.

Aplikacioni për pjesëmarrje në Konkurs duhet të dorëzohet në Agjencinë për të rinj dhe sport më së voni **deri më 18 dhjetor 2017 deri në ora 16.30** në adresën:

Agjencia për të rinj dhe sport
rr. "Makedonija" nr. 38 (Pallati "Panko Brashnarov")
1000 Shkup

Me shenjë: PËR KONKURS 2017

Dhe në mënyrë elektronike në e-mail:

Ognen Stojanovski – ognenstojanovski@hotmail.com

Natasha Smilevska – nsmilevska@hotmail.com

DREJTOR
Darko Kaevski

Në bazë të nenit 37, 38 dhe 39 të Ligjit për Policinë Financiare ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 12/14, 43/14, 33/15 dhe 27/16), neni 22 dhe 23 të Ligjit për Marrëdhënie Pune ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 62/05.....39/12), neni 17 të Ligjit për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017 ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 191/16), Komisioni për Zbatimin e Procedurës për Punësim pranë Ministrisë së Financave- Drejtoria për Polici Financiare publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 01/2017 për punësim në Drejtorinë e Policisë Financiare

Drejtoria për Polici Financiare ka nevojë për punësim në kohë të pacaktuar me orar të plotë të punës për 3 realizues, për vendin e punës në vijim:

1. Polic financiar – Udhëheqës i departamentit – inspektor kryesor për krim kompjuterik dhe forensikë digjitale shifra FIN 02 08 A03 001: Një (1) realizues i cili duhet të ketë të mbaruar shkallën e VII/1 të përgatitjes profesionale nga sfera e Teknikës kompjuterike dhe informatikës, Elektroteknikës, Informatikës dhe për nivelin A3 është e nevojshme së paku pesë vjet përvojë pune në profesion, me rrogë themelore në shumë neto prej 40.839,00 denarë.

2. Polic financiar – Inspektor i pavarur për marrje të përkohshme dhe ekspertizë të sistemeve kompjuterike shifra FIN 02 08 B01 001: Një (1) realizues i cili duhet të ketë të mbaruar shkallën e VII/1 të përgatitjes profesionale nga sfera e Teknikës kompjuterike dhe informatikës, Elektroteknikës, Informatikës dhe për nivelin B1 duhet së paku të ketë tre vjet përvojë pune në profesion, me rrogë themelore në shumë neto prej 37.215,00 denarë.

3. Polic financiar – Inspektor i lartë për krim kompjuterik dhe forensikë digjitale shifra FIN 02 08 B02 001: Një (1) realizues i cili duhet të ketë të mbaruar shkallën e VII/1 të përgatitjes profesionale nga sfera e Teknikës kompjuterike dhe informatikës, Elektroteknikës, Informatikës dhe për nivelin B2 duhet së paku të ketë tre vjet përvojë pune në profesion, me rrogë themelore në shumë neto prej 34.534,00 denarë.

Polic financiar mund të jetë personi i cili krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune, duhet të plotësojë kushtet në vijim në pajtim me Ligjin për polici financiare:

- Shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- I aftë psikofizikisht (person i aftë) dhe me predispozita për kryerje të punëve të policit financiar;
- Niveli i kualifikimit VI A sipas kornizës nacionale të kualifikimeve për arsim sipëror, së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 nga sfera Teknikë kompjuterike dhe informatikë, Elektroteknikë, Informatikë;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të gjuhës angleze përmes posedimit të certifikatës nga certifikatat e njohura ndërkombëtare të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit B2, nielit të CEFR gjegjësisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEK V, ILEK, IKFE, BULATS ose TOEFL PBT së paku 500 pikë, TOEFL CBT së paku 175 pikë ose TOEFL IBT së paku 60 pikë, jo më të vjetër se 5 vjet;

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- Certifikatë të shtetësisë së RM;
- Biografi personale (CV) jo më të madhe se 5 faqe, me kontakt telefon dhe adresë të nevojshme të shënuar;
- Letër motivimi prej së paku 500 fjalë;
- Diplomë për arsim të mbaruar;
- Dëshmi për gjuhë angleze, në pajtim me certifikatat e kërkuara;
- Dëshmi për njohje të aftësive kompjuterike.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në Arkivin e Drejtorisë për polici financiare ose përmes postës në adresën në vijim:

Drejtoria për polici financiare
Rr. Kej Dimitar Vllahov nr. 4, kati 4, 1000 Shkup
Me shenjë: për "SHPALLJE PUBLIKE NR. 01/2017".

Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve është shtatë (7) ditë pune, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor, gjegjësisht më së voni deri më: 21.12.2017.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar, nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e Komisionit për punësim në Drejtorinë për polici financiare.

Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitje të rregulluar për vendin e punës, do të realizohet intervistë në lokale të Drejtorisë për polici financiare.


Drejtoria për polici financiare do të realizojë zgjedhjen në afat në pajtim me nenin 39 të Ligjit për polici financiare.

Fillimi dhe mbarimi i orarit ditor dhe javor të punës për të gjitha vendet e shpallura të punës është përcaktuar prej ora 08:30 deri në ora 16:30, prej ditës së hënë deri ditën e premte.

Komisioni për realizim të procedurës për punësim

EDUKIMI I HERSHËM I FËMIJËVE

KOPSHTET TË OFROJNË GJITHË PËRFSHIRJE DHE CILËSI



Profesoresha universitare, Elizabeta Bajrami Ollogu, pohon se mënyra se si trajtohen në çerdhe fëmijët e moshës nga 2 deri në 5 dhe 6 vjet - është shumë e rëndësishme për zhvillimin psikomotorik të fëmijëve. Është pikërisht kjo moshë, e cila përkon me periudhën e zhvillimit të aftësive njohëse (kognitive) të fëmijëve, sqaron ajo

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 12 dhjetor - Socializmi i hershëm i fëmijëve, respektivisht regjistrimi i tyre nëpër kopshte dhe çerdhe para se fëmijët të nisnin arsimin e detyrueshëm - në moshën pesë vjet e gjysmë, po mbështete gjithnjë e më tepër nga ana e kompetentëve. Shumë studime mbështesin tezën se koha e përshtatshme për të çuar fëmijët në kopshte nis në moshën 18 muajsh ose dy vjeç. Kjo, pasi në këtë moshë ndërtohen mekanizmat trunorë, që në të ardhmen do të mundësojnë ose jo zhvillimin gjuhësor, fjalën dhe mendimin në nivele ose jo cilësore. Por paralelisht këtyre premisave, për shtete si Maqedonia me një koeficient jo edhe aq përfshirës të fëmijëve në çerdhe, është e nevojshme që të institucionet të mos luajnë vetëm rolin e mbikëqyrjes

pasive të fëmijëve, por të ofrojnë parasëgjithash programe edukative konform moshës së fëmijëve.

Profesoresha universitare Elizabeta Bajrami Ollogu, pohon se mënyra se si trajtohen në çerdhe fëmijët e moshës nga 2 deri në 5 dhe 6 vjet, është shumë e rëndësishme për zhvillimin psikomotorik të fëmijëve. Është pikërisht kjo moshë, e cila përkon me periudhën e zhvillimit të aftësive njohëse (kognitive) të fëmijëve, plotëson me tej ajo. Për një zhvillim sa më të mirë kognitiv, sipas saj, janë shumë të rëndësishëm ambienti familjar (pra vendi ku ai edukohet nga prindërit, gjyshërit apo motrat dhe vëllezërit) si dhe ambienti i jashtëm, për të cilin thotë se është hapi i dytë i socializmit të fëmijëve. Në këtë kontekst, plotëson me tej ajo, çerdhet dhe kopshtet përkohësisht me ambientin e dytë të socia-

lizmit të fëmijëve. Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë e tyre si mjedis social i fëmijës, cilësia e shërbimeve që ofrojnë çerdhet dhe kopshtet merr një vlerë të veçantë. Ollogu, profesoreshë e shkencave sociale në universitetin "Nëna Tereza", në Shkup, nënvizon faktin se rolin kyç në procesin e socializmit të fëmijëve në ambientin e jashtëm e merr edukatorja. Nga niveli i shkathtësive profesionale të edukatorëve në çerdhe dhe nga puna që bëjnë ato me fëmijët do të varet shumë edhe performanca e zhvillimit të aftësive njohëse të fëmijëve. Është shumë e rëndësishme, plotëson me tej ajo që edhe edukatorët të posedojnë shkollim adekuat, në bazë të kurrikulave bashkëkohore, sepse jo të gjitha lojërat që bëjnë fëmijët në çerdhe apo shtëpi kanë të njëjtin ndikim. "Janë disa lojëra, të cilësuar si psiko-

logjike, me të cilat edukatorët mund të ndikojnë mjaft mirë për zhvillimin emocional dhe kognitiv të fëmijëve të moshës 2 dhe 3 vjeç", sqaron ajo, ndërsa thotë se është i fuqishëm ndikimi që ka edukimi parashkollor në suksesin e shkollimit të mëtejshëm të fëmijëve.

Vite përpara, tregon Ollogu, Shoqata Amerikane e Psikologëve, ka realizuar një studim mbi lidhshmërinë e edukimit parashkollor me performancën e arsimimit të mëtejshëm të fëmijës. Rezultate e studimit flasin për ndikim të thellë që ka tek nivelet e mëtejshme të shkollimit edukimi parashkollor, mënyra se si fëmijët ndërtojnë marrëdhënien me edukatorët, fëmijë e tjerë dhe familjen. "Të gjitha studimet flasin për atë se fëmijët që shkojnë në kopsht kanë çdo herë premisën të jenë më të suksesshëm në vitet e mëvonsh-

me të arsimit dhe se tregojnë aftësi më të mira në procesin e të nxënies, janë më të predispozuar të zhvillojnë marrëdhënie sociale me fëmijë të tjerë dhe mësimdhënësit". Pra, që ky proces të realizohet në mënyrë sa më cilësore, specialistët rekomandojnë që fëmijët të çohen në kopshte, si vende të specializuara për të nxitur psikikën e fëmijës të zhvillohet në mënyrë sa më aktive. Në Maqedoni jo të gjithë nxënësit e moshës parashkollore frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet. Kjo ka të bëjë jo vetëm me mentalitetin për ta edukuar fëmijën më mirë në shtëpi, por edhe me një sërë faktorë tjetër të rëndësishëm sikurse janë (pa)mundësitë financiare dhe mungesa e kapaciteteve të institucioneve të edukimit parashkollor për t'ju përgjigjur të gjitha kërkesave.

Çmimi i ri i ujit pret Këshillin e ri drejtues



Shkup, 12 dhjetor - Ndërmarrja publike e Shkupit "Ujësjellësi dhe kanalizimi" ende nuk mund ta caktojë çmimin e ujit që duhet të zbatohet prej 1 janarit të vitit 2018 për shkak të skadimit të mandatit të Këshillit drejtues të ndërmarrjes. "Për shkak të përfundimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues të NP Ujësjellësi dhe kanalizimi - Shkup, ndërkaq duke pasur parasysh atë se, ende, nuk janë emëruar anëtarë të rinj, procedura rreth propozimit për çmimin e ujit, ende, nuk ka përfunduar", informojnë nga kjo ndërmarrje publike. Sqarojnë se në momentin kur do të emërohen anëtarët e rinj, procedura do të

mund të vazhdojë. Anëtarët e Këshillit drejtues të NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi" - Shkup vendosin rreth propozimit të Komisionit rregullator dhe vendimin e tyre ia dorëzojnë Këshillit të Qytetit të Shkupit. Këshillin drejtues e emëron, përkatësisht shkarkon Këshilli i Qytetit të Shkupit, ndërsa mandati i anëtarëve zgjat katër vite. Komisioni rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë, siç kumtoi MIA tashmë, më datën 24 të muajit të kaluar solli vendim për përcaktimin e tarifës mesatare minimale dhe maksimale për shërbimin e ujit, furnizimit me ujë të pijshëm apo furnizim me ujë. Qyteti i

Shkupit deri më 1 janar të vitit 2018 duhet t'i përcaktojë çmimet e reja të ujit në bazë të tarifës që e përcaktoi Komisioni rregullator për energjetikë. Sipas propozimit të KRRE çmimi i ujit për banorët në Shkup duhet të lëvizë mes 30.54 dhe 34.80 denarë. Tarifa mesatare për qytetin e Shkupit paraqet 32.68 denarë për metër kub ujë të shpenzuar. Çmimi i tanishëm mesatar paraqet 31.30 denarë. Kësaj i shtohet edhe dhëna e re të cilën shkupjanët do ta paguajnë prej vitit të ardhshëm për pastrim të ujërave ndotëse që sipas propozimit të KRRE-së paraqet 2,04 denarë për metër kub. Tarifat e përcaktuara nga ana e Komisionit rregullator për energjetikë, në pajtim me Metodologjinë, janë tarifa mesatare, që do të thotë se ofruerit e shërbimeve të ujit, në suaza të përcaktuara, vetë do ta caktojnë lartësinë e tarifave sipas kategorive të shfrytëzuesve - amvisëri dhe të tjerë. Komisioni rregullator për energjetikë i konfirmoi tarifën për 37 ndërmarrje ofruese të shërbimeve të ujit në vend.

Shilegov do të rrit numrin e biçikletave



Shkup, 12 dhjetor - Administrata e re e qytetit ka për qëllim përmes zgjidhjes ekologjike dhe moderne ta pakësojë trafikun në qendër të qytetit dhe të zvogëlohet emetimi i gazrave të dëmshme, theksoi dhe kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov në Konferencën rajonale "Rritja e numrit të biçikletave në Shkup" të mbështetur prej Shoqatës gjermane për bashkëpunim internacional (GIZ) dhe Qeverisë gjermane. "Me çdo rikonstruim të ri dhe rrugë të ndërtuar Qyteti i

Shkupit parashih ndërtimin e shtigjeve përkatëse për biçikleta dhe të këmbësorëve, ndërsa me qëllim që të mundësojnë mënyra alternative të lëvizjes së qytetarëve të Qytetit të Shkupit", tha Shilegov. Ai theksoi se Shkupi do të jetë qytet i moderuar dhe prosperues dhe paralajmëroi se plani i administratës së qytetit është Shkupi duhet të bëhet kryeqendër e gjelbër evropiane deri në vitin 2021 me funksionimin e qytetit me sistemin smart-siti.

Globalizimi i pakënaqësisë

Nga Joseph E. STIGLITZ



Pesëmbëdhjetë vite më parë, botova "Globalizimi dhe Pakënaqësitë e tij", një libër që synonte të shpjegonte pse kishin shumë pakënaqësi me globalizimin në vendet në zhvillim. Shumë thjesht, shumica besonte se sistemi ishte "manipuluar" kundër tyre dhe marrëveshjet globale të tregtisë veçoheshin se kishin qenë veçanërisht të padrejta. Tani pakënaqësia me globalizimin ka nxitur një valë populizmi në Shtetet e Bashkuara dhe ekonomitë e tjera të përparuarra, kryesuar nga politikanë që pretendojnë se sistemi është i padrejtë për vendet e tyre. Në SHBA, presidenti Donald Trump këmbëngul se negociatorët e tregtisë në Amerikë u përdorën nga ata të Meksikës dhe Kinës. Si mundet diçka që duhej t'i jepte përfitime të gjithëve, si vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, tani përçmohet thuhet kudo? Mundet një marrëveshje tregtare të jetë e padrejtë ndaj të gjitha palëve? Për ata në vendet në zhvillim, pretendimet e Trump – ashtu si Trump vetë – janë për të qeshur. SHBA në thelb i bëri vetë rregullat dhe krijoi dhe institucionet e globalizimit. Në disa nga këto institucione – për shembull, te Fondi Monetar Ndërkombëtar – SHBA ende ka fuqinë e vetos këtu, pavarësisht pakësimit të rolit të SHBA-së në ekonominë globale (një rol që Trump vetë duket i vendosur ta shkatërrojë dhe më keq).

Për dikë si unë, i cili ka parë nga afër negociatat e tregtisë për më shumë se çerek-shekulli, është e qartë se negociatorët tregtarë të SHBA-së thuhet morën atë që deshën. Problemi ishte me atë që ata deshën. Axhenda e tyre u vendos, pas dyerve të mbyllura nga korporatat. Ishte një axhendë e shkruar nga dhe për kompanitë e mëdha shumëkombëshe, në kurriz të punëtorëve dhe shtetasve të tjerë kudo. Në fakt, duket shpesh se punëtorët që kanë parë pagat e tyre të bien dhe punët të zhduken, janë thjesht dëm kolateral – viktimat të pafajshme, por të pashmangshme në një marshim të paepur drejt progresit ekonomik. Por ka një tjetër interpretim të asaj që ka ndodhur: një nga objektivat e globalizimit ishte të dobësonte fuqinë e negocimit nga punëtorët. Korporatat donin krah pune të lirë, sido që ta siguronin. Ky interpretim ndihmon në shpjegimin e disa aspekteve kyçe të marrëveshjeve tregtare. Pse ndodhi Kjo është arsyeja përse, për shembull, vende të zhvilluara hoqën dorë nga një prej

avantazheve të tyre më të mëdha, sundimit të ligjit? Në fakt, dispozitat e përfshira në shumicën e marrëveshjeve të fundit i japin investitorëve më shumë të drejta nga se u janë ofruar investitorëve në SHBA. Ata janë të kompensuar, për shembull, nëse qeveria duhet të miratojë një rregullim që i prek ata për keq, pavarësisht se sa i dëshirueshëm është ky rregullim apo sa i madh është dëmi i shkaktuar nga korporata pa të.

Ja tre përgjigje ndaj pakënaqësisë së globalizuar me globalizimin. Së pari – ta quajmë strategjia e Las Vegasit – është të dyfishohet basti për globalizimin duke parë siç është menaxhuar në çerek-shekullin e shkuar. Ky bast, si të gjitha bastet e politikave të provuara një dështim (si për shembull ekonomia e pakësimit të taksave ndaj bizneseve) bazohet në shpresën se në një farë mënyre do të ketë sukses në të ardhmen. Përgjigjja e dytë është Trampizmi: të tërhiqesh nga globalizimi, në shpresë se duke vpruar kështu do të kthesh pas një botë të shkuar. Por protektionizmi nuk funksionon. Në shkallë globale, punët në prodhim po ulen, thjesht sepse rritja e produktivitetit ka tejkaluar kërkesën. Edhe nëse prodhimi do të kthehej, kjo nuk do të thotë më

shumë vende pune. Teknologjia e përparuar në prodhim, përfshirë robotët, do të thotë se ato pak vende pune të krijuara do të duan aftësi të larta pune dhe do të shkojnë në vende të ndryshe nga ato ku janë humbur punësimet. Ashtu si dyfishimi, kjo qasje prirë të dështojë, duke shtuar më tepër ndjesinë e pakënaqësisë nga ata që kanë mbetur pas. Trump do të dështojë në këtë synim të shpallur për të pakësuar deficitin tregtar, që përcaktohet nga pabarazia mes kursimeve vendase dhe investimit. Tani që republikanët kanë marrë pushtetin dhe kanë vënë në punë një ulje taksash për miliarderët, kursimet kombëtare do të bien dhe deficitin tregtar do të shtohet, prej një rritje në vlerë të dollarit. (Deficitet fiskale dhe ato tregtare normalisht ecin krah njëri-tjetrit ndaj quhen deficite "binjake"). Trump mund të mos i pëlqejë, por ai po zbulon ngadalë se ka disa gjëra që edhe një person me pozicionin më të fuqishëm në botë mund të mos i kontrollojë.

Ka edhe një qasje të tretë: mbrojtje sociale pa protektionizëm, ajo qasje që ndoqën vendet e vogla nordike. Ata e dinin se si vende të vogla duhej të qëndronin të hapura. Por gjithashtu e dinin se duke qenë të ha-

Globalizimi, i cili supozohej t'i sillte përfitime vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, tani përçmohet thuhet kudo, siç ka treguar reagimi kundër tij në SHBA dhe EUropë në vitet e fundit. Sfidat është të minimizohet rreziku i shtimit të zemërimit dhe të fillohet të mësohet nga gabimet e të shkuarës.



pura i ekspozonin punëtorët ndaj rrezikut. Kështu ato duhej të krijonin një kontratë sociale që ndihmonte punëtorët të kalonin nga punët e vjetra te të reja dhe duke ofruar ndihmën e tyre mes këtij procesi. Vendet nordike janë shoqëri shumë demokratike, ndaj e dinin që pa e ndjerë të gjithë punëtorët se globalizimi i sillte përfitim, nuk mund të qëndronte. Dhe të pasurit në këto vende e kuptuan se nëse globalizimi punonte siç duhej, do të kishte mjaftueshëm përfitime edhe për ta. Kapitalizmi amerikan në vitet e fundit është përshkruar nga një lakmi e shfrenuar – kriza financiare globale e vitit 2008 e konfirmon këtë. Por siç kanë treguar disa vende, një ekonomi tregu mund të marrë të gjitha format që sprovonjë si kapitalizmin dhe globalizimin dhe japin rritje më të qëndrueshme dhe standarde më të larta jetese për shumicën e shtetasve. Mund të mësojmë prej disa sukseseve se çfarë të bëjmë, ashtu sikurse mund të mësojmë nga gabimet e të shkuarës çfarë të mos bëjmë. Siç është bërë e qartë, nëse nuk e menaxhojmë globalizimin që t'i sjellë përfitime të gjithëve, kundërreagimi – nga Pakënaqësitë e Reja në Veri dhe Pakënaqësitë e Vjetra në Jug – ka rrezik të shtohet. (reporter.al)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 12 dhjetor | Numri i parë i gazetës do të më 22 Nëntor 2006
 Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
 E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
 Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Kurthi i “formulës ukrainase” për Kosovën në OKB



Nga Shaban MURATI

Plani konsiston në atë që Serbia t'i ofrojë Kosovës anëtarësimin në OKB, por pa e njohur Kosovën si shtet. Në shkëmbim, Kosova duhet të ndihmojë Serbinë të anëtarësohet në BE, duke hequr dorë nga kërkesa e njohjes së Kosovës. Ky do të ishte sipas Beogradit thelbi i asaj, që po cilësohet si marrëveshje përfundimtare midis Serbisë dhe Kosovës. “Kosova mund të marrë vendin në OKB vetëm nëpërmjet marrëveshjes me Serbinë dhe Serbia duhet të marrë diçka”,-deklaroi në datën 5 dhjetor presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Kur Sonja Biserko, presidente e Komitetit të Helsinkit të Serbisë, e pyeti se çfarë është kjo “diçka”, Vuçiq tha se nuk dëshiron të flasë tani, por do ta bëjë nga marsi ose prilli. Sipas burimit diplomatik, që përmendëm në fillim të analizës, kjo “diçka” është heqja dorë e Kosovës nga njohja prej Serbisë në shkëmbim të lejes serbe për të marrë një karrige në OKB. Plani diplomatik serb ka nisur të diskutohet në disa qarqe të mbyllura diplomatike europiane dhe diplomacia serbe është në fazën e sigurimit të mbështetjes nga shtete të BE për këtë plan të saj. Burimi diplomatik perëndimor nga Beogradi bën, gjithashtu, të ditur se plani serb është konsultuar paraprakisht me Moskën dhe ka siguruar miratimin rus, sepse pa votën e Rusisë në Këshillin e Sigurimit në OKB nuk mund të hapet rruga e anëtarësimit të Kosovës në OKB, ashtu siç është veto ruse pengesa kryesore e anëtarësimit të Kosovës në OKB. Në disa qarqe diplomatike kanë shfaqur interesim për këtë plan të diplomacisë serbe “për të ofruar anëtarësimin në OKB pa pranuar njohjen e Kosovës si shtet”, sepse është shtuar lodhja e Brukselit përballë një problemi të madh dhe të vështirë, siç janë marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës, dhe do të shpëtojë një orë e më parë nga ky telash. Çështja kryesore është se si do të jetë qëndrimi diplomatik dhe strategjik, që do të përcaktojë Kosova ndaj këtij plani serb. Diplomacia dhe institucionet e nëndheshme serbe, që kanë lidhje okulte me struktura të ndryshme në Kosovë, po përpiqen që në forma dhe rrugë të shumëllojta t'i krijojnë hapësirë pranimit të këtij plani serb në Prishtinë. Ka indikacione se në drejtim të këtij objektiv ata kanë arritur njëfarë suksesi, sepse në disa qarqe qeveritare në Prishtinë ka nisur të

qarkullojë teza e habitshme se “Serbia nuk ka përse ta deklarojë se e njeh Kosovën”, çka në një farë kuptimi mund të merret si një sinjal i pranimit indirekt të planit serb.

QËNDRIMI TOLERANT I QEVERISË SË KOSOVËS

Në hartimin e planit të tyre qeveria dhe diplomacia e Serbisë duhet të jenë inkurajuar edhe nga qëndrimi tolerant, me tepër se sa duhet, i qeverisë së Kosovës, e cila në bisedimet e Brukselit me Serbinë sorollatet prej gjashtë vitesh në unazën e vogël të bisedimeve teknike dhe administrative. Nuk është bërë asnjëherë e qartë se sa vite duhet të kalojnë për të dalë në trasenë e vërtetë të bisedimeve politike për legalizimin e statusit të bisedimeve si bisedime midis dy shteteve dhe në finalizimin e qëllimit të natyrshëm për njohjen e shtetit të pavarur të Kosovës. Qeveria dhe diplomacia e Serbisë janë inkurajuar edhe nga qëndrimi tolerant i Qeverisë së Kosovës, e cila nuk ka reaguar asnjëherë në tryezën e bisedimeve për situatën absurde, kur çdo ditë qeveria dhe diplomacia e Serbisë vrapojnë nëpër botë për të penguar njohjen e Kosovës. Beogradi shkel çdo ditë marrëveshjen e famshme të “normalizimit të marrëdhënieve” me Kosovën të 19 prillit 2013, ku është angazhuar të pranojë anëtarësimin e Kosovës në BE si shtet dhe Prishtina shkon nga një raund bisedimesh në tjetrin sikur nuk ka ndodhur gjë. Përshlyerja e krijuar nga diplomatët, që i ndjekin prej vitesh raportet midis Serbisë dhe Kosovës, është se nga bisedimet midis dy shteteve me ndërmjetësimin e BE, pala që ka fituar më shumë është Serbia. Serbia siguroi nëpërmjet këtyre bisedimeve dhe kërkesave teknike të Kosovës, alibinë e madhe për “qetësimin e marrëdhënieve”, gjë që i hapi rrugën asaj për marrjen e statusit të shtetit kandidat në BE dhe për hapjen e bisedimeve të pranimit me BE-në.

Tani jemi në një fazë të re, kur Serbia po avancohet në hapjen njeri pas tjetrit të kapitujve të Traktatit të pranimit në BE dhe kur, siç deklaroi presidenti Vuçiq në 5 dhjetor, ajo parashikon që në vitin 2022 të bëhet anëtare e plotë e BE. Por për këtë ka një kusht të madh, që quhet kushti i kushteve, që Serbia dhe Kosova të njohin njëra-tjetrën. Pikërisht në këtë klimë, pra me afrimin

e datës kur kushti i kushteve do të ngrihet në fund të tratativave të pranimit midis BE dhe Serbisë, qeveria serbe harton planin e saj të fshehtë të ofertës për Kosovën që të anëtarësohet në OKB, por të heqë kërkesën e njohjes si shtet nga Serbia. Një marrëveshje mbi këtë pazar, nëse pranohet nga Prishtina, i lejon Serbisë ta heqë kushtin e kushteve të BE me dorën e vetë Kosovës. Dhe pas kësaj, duke qenë anëtare e BE, Serbia jo vetëm do të bëhet shteti i gjashtë i BE, që nuk njeh Kosovën, por do ta blloktojë integrimin e Kosovës në BE.

Përballë këtij plani të rafinuar diplomatik serb, Kosova duhet të tregojë një syçeltësi të jashtëzakonshme dhe të mos bëjë as indulgjencë të nxituara dhe as hapa, që i shkojnë lojës së Serbisë. Oferta serbe për Kosovën në OKB pa e njohur Kosovën si shtet është një kurth serb kundër pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit shtetëror të Kosovës. Çfarë do të thotë konkretisht një ofertë e tillë dhe a duhet ta pranojë Kosova? Së pari duhet thënë se Kosova duhet të peshojë nga pikëpamja strategjike prioritetin se çfarë i duhet asaj më shumë: anëtarësimi në OKB apo njohja si shtet i pavarur nga Serbia. Përgjigja, që dikton interesi kombëtar i sigurisë, i stabilitetit dhe i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, është se Kosovës i duhet më përpara që të njihet nga Serbia si shtet i pavarur, gjë që do të thotë që Serbia të heqë dorë nga rivendikimet koloniale mbi Kosovën, të cilat i ka shkruar edhe në Kushtetutën e saj. Kosova duhet ta ketë të qartë se nga njohja e Serbisë si shtet i pavarur ajo do të shkojë tek anëtarësimi në OKB, por nga anëtarësimi në OKB nuk mund të shkojë dot te njohja e saj prej Serbisë. Formula e qeverisë serbe me planin e ri për t'i ofruar Kosovës anëtarësimin në OKB, por pa e njohur atë, është, në fakt, një formulë dinake, që unë do ta quaja “formula ukrainase”. Formula ukrainase është që një entitet bëhet anëtar i OKB, pa u njohur si shtet i pavarur dhe duke pasur statusin e të qenit pjesë e një shteti tjetër. Njësoj siç u bë Ukraina anëtare e OKB në vitin 1945 dhe ishte pjesë e një shteti tjetër, e Bashkimit Sovjetik.

JOSHJA PREJ KARRIGES NË OKB

Pra, anëtarësia në OKB nuk i dha Ukrainës statusin e shtetit të pava-

rur dhe as të njohur ndërkombëtarisht si subjekt i pavarur i së drejtës ndërkombëtare. Askush nuk vendosi marrëdhënie diplomatike me Ukrainën deri në vitin 1991, kur pas prishjes së Bashkimit Sovjetik, ajo u bë shtet vërtet i pavarur. Pikërisht këtu qëndron thelbi i dinakerisë bizantine të qeverisë dhe të diplomacisë serbe.

Duke i ofruar Kosovës anëtarësimin në OKB, ata jo vetëm nuk e njohin Kosovën si shtet, por sanksionojnë të drejtën ta konsiderojnë pjesë të Serbisë, njësoj si Bashkimi Sovjetik dikur Ukrainën. Institucionet qeveritare të Kosovës duhet të jenë tepër të vëmendshme dhe të mos hutohen nga joshja prej karriges në OKB. Kina, një fuqi e madhe, mbeti 22 vjet jashtë radhëve të OKB. Ka edhe një element tjetër të rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë. Anëtarësimin në OKB Kosovës mund t'ia japë Rusia, duke hequr veton si anëtare e KS të OKB, dhe jo Serbia, sepse po desh Rusia, Kosova hyn në OKB edhe pa lejen e Serbisë. Por nuk desh Rusia, Kosova nuk hyn në OKB edhe sikur të dojë Serbia. Pra, Serbia po kërkon të shesë diçka, që në fund të fundit nuk është kompetencë e saj. Nuk besoj se Rusia do të futet në një pazar të vogël ballkanik për sytë e bukur të Serbisë. Po të vijë puna deri futja e Kosovës në OKB, Rusia do t'i kërkojë Perëndimit diçka të madhe mbibalkanike, që ka lidhje me Krimenë, me Abhazinë apo Osetinë e Jugut. Problemet e mprehta të kërcënimit për sigurinë dhe sovranitetin e Kosovës vijnë nga Serbia dhe jo nga OKB.

Ato probleme nuk i zgjidh OKB-ja. Ndaj Kosova duhet të jetë e qartë dhe e ftohtë që bisedimet midis Serbisë dhe Kosovës nuk po bëhen për të hyrë në OKB, por që të përfundojnë në një marrëveshje apo traktat të njohjes reciproke midis dy shteteve. Anëtarësimi në OKB është objektiv pas sanksionimit të njohjes së Kosovës nga Serbia, sepse njohja mbyll zyrtarisht dhe juridikisht çdo rivendikim serb ndaj saj. Është tepër e rëndësishme që Kosova në kanale diplomatike të hedhë poshtë planin serb të “formulës ukrainase” dhe t'i bëjë të qartë Serbisë, por edhe BE-së, se Kosova nuk do t'ia japë Serbisë alibinë e re të OKB. Zgjidhja e vetme për normalizimin e marrëdhënieve është respektimi i kushtit të kushteve, që është njohja e Kosovës nga Serbia. (bv)

Një burim diplomatik perëndimor nga Beogradi bën të ditur se qeveria serbe ka hartuar një plan të fshehtë për të kapërcyer kushtin e kushteve, që BE i ka vënë Serbisë për anëtarësim dhe që është njohja e Kosovës



ADEM YMERI, KOMPOZITOR



Kam filluar të kompozoj qysh në moshën 12 vjeçare. Deri më tani kam kompozuar mbi 200 këngë, ku më së shumti përfshihen këngët për fëmijë. Shumica e këngëve të mia për fëmijë janë kënduar në festivalet tona dhe jashtë shtetit: si në Shqipëri, Kosovë, Bullgari, Egjipt, Mal të Zi etj. Disa prej tyre janë bërë hit dhe këndohen edhe në ditët e sotme. Kurse si kompozitor i këngëve për të rritur jam përfshirë në "Eurosongun" RTSH, ku Festivali ka karakter garues për pjesëmarrje në EVROVISION. Këngët e mia të kompozuar janë prezent edhe në shumë shtete ballkanike. Disa nga këto këngë artistike janë me motiv patriotik dhe këndohen nëpër festa të ndryshme kombëtare si: "Trëndafilat e Prekazit", e kompozuar gjatë luftës së Kosovës, "Pavarësia", "Mbretëresha Teutë" "Shqipëri nëna jonë" etj

SHUNDI KA SULMUAR MUZIKËN E MIRËFILLTË

Koha

Delvina KËRLUKU

KOHA: Një libër është një histori për mendjen. Një këngë është një histori për shpirtin. Çfarë është muzika, për një Ju? Çfarë sfidoni për muzikën?

YMERI: Prej fëmijërisë së hershme e kam dashur tejmase dhe e kam idealizuar artin muzikor. Kujtoj se një grup i vogël i njerëzve lind me një mision dhe Perëndia ua fal dhuntinë për të krijuar dhe për ta sofistikuar punën e tyre. Rruga e artit

është e mundimshme, kur bën përpjekje të ofrosh sublimen, të ofrosh vlera. Muzika është puhiza përkëdhelëse që më rrëmbu e më futi në rrugën e artit, qoftë ajo e kompozimit të këngëve të reja ose kënga ime që unë e këndoj në bashkëpunim me tekst-shkruesin, me kompozitorë tjerë dhe me shumë bashkëpunëtorë. Mendoj se të gjitha vlerat duhet të gërshetohen që të del një këngë e mirëfilltë. Këtë e kam bërë unë gjatë udhës time, prej moshës rinore e deri tani kur pjekuria

ime krijuese, ka arritur në shkallët më të larta. Unë si kompozitor, kantautor dhe autor i muzikës vokale, korale-instrumentale kam krijuar identitetin tim. Muzika është pasuria ime. Ajo më zgjon nga gjumi, ajo më dhuron elan për jetë, ajo ma nxjerr gjumin orëve të vona kur më vjen në mendje ndonjë notë me qëllim që ta stolisi këngën. Në këto kohë kur shundi ka sulmuar muzikën e mirëfilltë, unë me fanatizëm jam munduar t'i ruaj vlerat muzikore, qoftë tek këngët për fëmijë, qoftë tek



këngët për të rritur ose te zhanret tjera.

KOHA: Këndimi i këngëve didaktike për fëmijë, me tematikë të larmishme për atdheun, natyrën, familjen, shoqërinë, të huaja etj, janë përfshirë në programin mësimor të shkollave. Mund të bëni një përshkrim të orës së mësimi, ku ju keni mësuar? Çfarë mangësi, ka pasur atëbotë?

YMERI: Veprimtarinë e kam ndarë në shumë forma. Në botën e fëmijëve jam futur prej kontakteve të para të punës sime në arsim ku kam ligjëruar arsimin muzikor. Fëmijët i kam motivuar, që mbi të gjitha ta duan këngën e bukur shqipe, kompozitorët shqiptarë dhe ata botëror, duke iu demonstruar me instrumente dhe këndim. Përveç asaj, ua kam mbjellë në shpirt finesat muzikore dhe llojet e zhanreve. Kështu që kam arritur të zbuloj talent të ri, nxënës që kanë vesh muzikor. Duke i dëgjuar talentët e ri, nxënësit e mi të dashur më lindi ideja që të kontribuoj në një formë më profesioniste për t'i afruar fëmijët më afër artit muzikor. Jetoj në një vend ku gjithmonë kanë munguar festivalet e këngëve për fëmijë dhe për të rritur. Kuptohet që politikat kulturore kanë qenë të atilla dhe ne nuk kemi pasur mundësi materiale që t'i motivojmë fëmijët për të kënduar dhe për t'u formuar ata si këngëtarë profesionistë. E vetmja rrugë që fëmijët e talentuar të dëgjoheshin nga artdashësit muzikor, kanë qenë mediet, d.m.th. radio dhe televizioni. Me përkrahjen e televizionit lokal "Era", organizuam festivalin e parë për fëmijët shqiptar në RM, të cilin e quajtëm "Bilbilat këndojnë". Unë mora përgjegjësinë e udhëheqësit artistik dy vite me radhë. Pas ndërprerjes së këtij festivali, përsëri u formua vakumi i njëjtë shterpë, njësoj si në kohën kur nuk ekzistonte asnjë festival për fëmijët tanë.

Ishte periudha e tranzicionit kur bashkimi kulturor u realizua me Shqipërinë dhe Kosovën. Fillova bashkëpunimin me Festivalin prestigjioz shkodran, prej ku kanë lindur këngëtarët, kompozitorët më të mëdhenj shqiptarë. Udhëheqja organizative artistike më zgjodhi mua si koordinator për Republikën e Kosovës dhe për Republikën e Maqedonë.



donisë. Në prillin e vitit 2000 vendosa themelet e një Festivali të ri me karakter mbarëkombëtar. Me konsideratë do ta përmendi emrin e intelektualit Alush Hamidi, i cili festiva- lin e pagëzoi me emrin "YLBერი".

Ishin kohëra pak më të vështira. Kur unë mësoja, mungonin tekstet shkollore, librat didaktik, mungonin kabinetet e lëndës së muzikës, mungonin instrumentet muzikore. Probleme të këtitlla të ngjashme kemi edhe në ditët e sotme kur na mungojnë kabinetet, tekstet e mirëfillta etj. Përveç kësaj, ndodhi që të rasisim në pengesa të natyrave të ndryshme të cilat me shumë vështirësi mundohemi t'i tejkalojmë.

KOHA: Keni kompozuar mbi njëqind këngë, si nisi rrugëtimi juaj si kompozitor? Çfarë do të thonë këto këngë, janë një pasuri kombëtare?

YMERI: Kam filluar të kompozoj qysh në moshën 12 vjeçare. Deri më tani kam kompozuar mbi 200 këngë, ku më së shumti përfshihen këngët për fëmijë. Shumica e këngëve të mia për fëmijë janë kënduar në festivalet tona dhe jashtë shtetit: si në Shqipëri, Kosovë, Bullgari, Egjipt, Mal të Zi etj. Disa prej tyre janë bërë hit dhe këndohen edhe në ditët e sotme. Kurse si kompozitor i këngëve për të rritur jam përfshirë në "Euro-songun" RTSH, ku Festivali ka karakter garues për pjesëmarrje në EVRO-VIZION. Këngët e mia të kompozuar janë prezent edhe në shumë shtete ballkanike. Disa nga këto këngë artistike janë me motiv patriotik dhe këndohen nëpër festa të ndryshme kombëtare si: "Trëndafilat e Prekazit", e kompozuar gjatë luftës së Kosovës, "Pavarësia", "Mbretëresha Teutë" "Shqipëri nëna jonë" etj. Këto këngë janë perla që në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni këndohen me admirim në shumë raste solemne.

Si kompozitor dhe autor e veçor këngën "Pena jote", tekstin e së cilës e ka shkruar miku im i respektuar dhe shumë i shtrenjtë për mua, që tani më është i ndjerë. Bëhet fjalë për autorin Fatmir Fejzullahu. Ai tekstin ia kushtoi shkrimtares dhe arsimtares së njohur Puntorie Muça-Ziba, koleges dhe bashkëpunëtores tonë. Kjo këngë u mirëprit dhe u përshëndet nga publiku.

Si autor i muzikës instrumentale shpresoj që miniaturat për piano dhe veprën tjetër "Katër duar për piano", në ardhmëri do ta ekzekutojnë pianistët e mirëfilltë të vendit tonë.

KOHA: "O zambak i Prizrenit", kënga që identifikon qytetin e Prizrenit, ku edhe jeni shkolluar. Çfarë flet, ky qytet, në jetën tuaj?

YMERI: Prizreni është qyteti im më i preferuar. Atje ndjehem si qytetar i natyralizuar. Në atë qytet të bukur, kreu shkollën e mesme. Me atë vend magjik më lidh "Zambaku i Prizrenit", kënga dhe dashuria ndaj muzikës etj. Kujtoj se në qytetin mahnitës që unë do ta quaja qyteti i kishave dhe xhamive, vinin muzat e më frymëzonin në netët e gjata. Ish-te koha e komunizmit. Atje nuk harroheshin këngët e vjetra dhe çdo vit këndoheshin këngët e reja në tri gjuhë. Për çdo vit më janë pranuar dy ose tri këngë ku kam kënduar solo ose duet.

KOHA: Tridhjetë e pesë vite keni punuar në arsim, si profesor i muzikës. Çfarë ju lidhi me peda-



gogjinë, dashuria ndaj arsimit?

YMERI: Rastësia apo fati mi hapi dyert që unë të punoj vite të tëra në arsimin fillor ku për fat të mirë u ballafaqova me shumë talent të ri që i frymëzoja dhe i ndihmoja të dilnin në sipërfaqe si këngëtarë të vegjël. Ata qenie të njoma rriteshin dhe rriten akoma si këngëtar të mëdhenj. Shpesh mendoj përse unë mbeta në arsim. Mbase hyjnorja qëndron te bashkëpunimi im me nxënësit. Kur unë u punësova, ata për herë të parë dëgjuan këngë të kompozuar shqipe për fëmijë. Fëmijët nuk i kishin dëgjuar ndonjëherë këto këngë në shtëpitë e tyre, por as në shkollat ku mësonin, ngaqë arsimtarët kanë qenë maqedonas. Tërë kjo i mahnishte. Ata filluan ta adhurojnë artin muzikor dhe të shprehin dëshirë që të këndojnë. Ndjehem shumë krenar që vazhdoj ta kryej me sukses misionin tim. Pas shumë peripecive dhe zhgënjimeve unë si entusiast arrita ta hapi shkollën e ulët të muzikës në kuadër të shkollës "Ilija Nikollovski Llui" me paralele në gjuhën shqipe. Por, paralelen e parë e formova në shkollën fillore "Jane Sandanski"-Shkup, atje ku punoj. Arsimimi i nxënësve që në këtë shkollë mësonin në gjuhën maqedonishte dhe dëshironin ta ndjekin mësimin në gjuhën shqipe u zvarrit edhe plot katër vite për arsye se shumica iu largoheshin përgjegjësisë. Me iniciativën time dhe të prindërve, arritëm ta realizojmë misionin tonë. Por, këtë veprim e përsheptuam me ndihmën e Z. Avdyl Smaili, i cili ishte njëri nga prindërit që insistonte për t'u hapur paralelja në gjuhën shqipe. Gjatë asaj kohe patëm takim me përfaqësuesin e shkollave të mesme Z. Agim Fazliu i cili na përkrahu maksimalisht për ta vazhduar punën e nisur.

KOHA: Keni krijuar këngë, muzikë, festival, pse nuk ka një libër në Maqedoni, me kompozitorë e tekst-shkrues shqiptar, që të nxënë nxënësit shqiptar mësim mbi veprimtarinë e artistëve tanë?

YMERI: Lidhja e Pedagogëve dhe Artistëve Shqiptar në Maqedoni, ku aktualisht jam kryetar, edhe pas shumë takimeve nuk arriti ta bën ndryshimin e teksteve didaktike muzikore për shkollat fillore, ngaqë Ministria e Arsimit, nuk i botoi dorë-



shkrimet e krijuesve shqiptarë të kërkuara nga vetë ata. Arsyen e tregoi ish ministri shqiptar, i cili tha se ligji për ndryshimin e teksteve muzikore duhet të ndërrohet në Parlamentin e Maqedonisë. Po e cekim se ligji i mëparshëm për arsim ka qenë: "Të gjitha librat mund të botohen në gjuhën maqedonase, kurse për nacionalitetet tjera duhet përkthehen." Përkthimi i një teksti muzikor për fat të keq është bërë nga njerëz të papërgjegjshëm dhe jo profesionist, nga njerëz që nuk e njohin mirë gjuhën shqipe, rimën, ritmin etj. kështu që librat muzikor janë të bastarduar dhe të papërshtatshëm për realizimin e programit të lëndës muzikore në gjuhën shqipe. Lidhja e Pedagogëve të Muzikës ka alarmuar çështjen vite me radhë dhe kemi marrë qëndrim bashkë me prindërit që ato libra të mos i përdorim gjatë procesit mësimor muzikor. Ne si Lidhja e Pedagogëve muzikorë, hartuam një doracak me 120 këngë të autorëve të ndryshëm shqiptarë, me qëllim që ky doracak të përdoret si ndihmës për mësuesit nëpër shkollat fillore dhe ata mesme. Ndjehem krenar që kam qenë mbartës i punëve rreth përpunimit, redaktimit dhe botimit të doracakut. Njëkohësisht jam autor i librit për klasën e katërt të shkollave fillore. Shpresojmë se Qeveria e re do ta re-

gullojë këtë problem fatal.

KOHA: Më shumë dëshironi të këndon, apo kompozoni këngë?

YMERI: Pasioni im është kënga dhe kurrë nuk do të shkëputem nga ajo, por kohën e fundit më së shumti i jam përkushtuar kompozimit të këngëve për të rritur, për fëmijë dhe muzikës instrumentale për piano. Në mendje më fle një projekt i cili do ta rumbullakonte tërë veprimtarinë time krijuese 50 vjeçare, ku përveç meje do të performojnë fëmijët, solo këngëtarët, pianistët etj.

KOHA: Familja dhe muzika, çfarë kanë të përbashkët dhe a kanë të njëjtën mbështetjen tuaj?

YMERI: Për mua muzika është familje dhe familja është puhizë muzikore që më përkëdhel dhe më mbështet. Vajzat e mia ndoqën rrugën time dhe jam shumë i gëzuar për këtë. Ata hap pas hapi më përco- lën. Zana, vajza e madhe bëri master për piano dhe punon në shkollën e mesme të muzikës, kurse Edona së shpejti do të diplomohet për piano. Mbështetjen më të fuqishme e kam pasur gjithmonë nga bashkëshortja ime, Burbuqja, e cila me profesion është psikologe. Jam shumë mirënjohës që ajo gjithnjë qëndroi pranë meje dhe pranë dy vajzave tona të dashura.

Puna përgatitore për fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë në Bruksel, është duke vazhduar, thonë zyrtarët e institucioneve të larta të vendit. Sipas tyre, faza e fundit e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, do të duhej të përfundonte me njohjen e ndërsjellë të të dyja vendeve



Kosova, kusht i Serbisë drejt BE-së

Bashkimi Evropian dje ka hapur kapitujt e rinj të bisedimeve për anëtarësim për Malin e Zi dhe Serbinë, vende këto për të cilat shefi i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, thotë se pret të anëtarësohen në bllok deri më 2025. Negociatat për anëtarësim, që zakonisht zgjasin me vite, janë të ndara në 35 "kapituj" që përfshijnë fusha si ekonominë, energjinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut, për t'i ndihmuar shtetit aspirues për anëtarësim t'i harmonizojë praktikatat e veta me standardet e BE-së. Në një konferencë për media, Komisioneri për Zgjerim i BE-së, Johannes Hahn, ka thënë se hapja e këtyre kapitujve për Serbinë është arritje e merituar për vendin. Por ai paralajmëroi se progresi i mëtejshëm i shtetit serb është i kushtëzuar me Kosovën. "Progresi i mëtejshëm është i kushtëzuar në përqendrimin [e Serbisë] ndaj sundimit të ligjit dhe normalizimit [të raporteve] me Kosovën", tha Hahn, transmeton Koha.net. Ai theksoi se është bërë punë e mirë në raport me Kosovën dhe me sundimin e ligjit, por "ende ka sfida". BE ka hapur dy kapituj të rinj edhe për Malin e Zi, të cilët përfshijnë lirinë e lëvizjes për punëtorët dhe shërbimet. Kjo nënkupton se Mali i Zi tani ka edhe 30 kapituj për t'i hapur. Nga rajoni, Shqipëria dhe Maqedonia janë kandidatë për anëtarësim në BE.

DIALOGU S'DO TË JETË PENG I MUNGESËS SË EKIPIT TË UNITETIT

Bekim Çollaku, shef i kabinetit të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, duke folur për Radion Evropë e Lirë, thotë se presidenti i vendit është duke punuar në të gjitha rrafshet për ndërtimin e një Ekipi të Unitetit apo një grupi gjithëpërfshirës, i cili do ta përfaqësojë Kosovën në fazën, siç e ka quajtur ai, përfundimtare të dialogut në Bruksel. Sipas tij, me grupin e unitetit nënkuptohen përfaqësuesit e partive politike parlamentare. "Nëse partitë politike parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës do të arrijnë të gjejnë një konsensus të tillë, që të merren vesh aty dhe të nxjerrin një rezolutë të përbashkët për këtë çështje, aq më mirë. Mirëpo, nëse jo, atëherë pse jo edhe presidenti, si përfaqësuesi më i lartë institucional dhe si përfaqësues i unitetit të popullit dhe i partive politike, mund të krijojë ekipin politik për qëllimin e njëjtë. Kështu që, në cilëndo formë që të bëhet, sukcesi është i garantuar. Ajo çfarë është më e rëndësishme, është që të ketë konsensus të gjerë politik për këtë çështje, ndërsa mënyra se si do të ndërtohet kjo, mendoj se është e një rëndësie dytësore", thotë Çollaku.

Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës thonë se Kuvendi i Kosovës tashmë e ka të miratuar një rezolutë, me të cilët i autorizon krerët institucionalë të Kosovës për dialog me Serbinë. Halil Matoshi nga kabineti i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, thotë për Radion Evropë e Lirë se Qeveria e Kosovës është e angazhuar për arritjen e një konsensusi ndërmjet partive politike për krijimin e një grupi gjithëpërfshirës për përfaqësim të vendit në dialogun me Serbinë. "Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me krerët institucionalë të Kuvendit dhe me presidentin, janë duke ndërtuar një ekip, një strategji të unifikuar, që të rinisë, përkatësisht, që dialogu me Serbinë të hyjë në fazën përfundimtare, duke e afatizuar në kohë dhe që rezultati përfundimtar i tij të jetë njohja e ndërsjellë e të dy shteteve", thotë Matoshi. Por, përfaqësuesit e partive politike parlamentare në vend, tashmë kanë shprehur mendime të ndryshme lidhur me mundësinë e krijimit të një ekipi gjithëpërfshirës apo të unitetit për dialogun me Serbinë. Përderisa Lëvizja Vetëvendosje vazhdon të jetë kundër dialogut pa

kushte me Serbinë, si dhe kundër asaj që përfaqësimin e Kosovës në dialog ta udhëheqë presidenti Thaçi, Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk e ka mohuar në parim mundësinë e krijimit të një ekipi gjithëpërfshirës. Megjithatë, sipas tyre, për nivelin e përfaqësimit politik në dialog, fjalën e fundit duhet ta thotë Kuvendi i Kosovës, si dhe ka shprehur mendimin që dialogun duhet ta udhëheqë Qeveria dhe jo nga presidenti. Por, Çollaku konsideron se kjo qasje e partive opozitare është e gabuar, duke thënë se Kushtetuta e Kosovës i përcakton qartë rolet e institucioneve të larta. "Në këtë rast, dialogu është një çështje e politikës së jashtme dhe Kushtetuta e përcakton qartë që me politikë të jashtme udhëheqë presidenti i vendit. Mirëpo, do të ishte tepër e mirëseardhur në qoftë se Kuvendi i Republikës së Kosovës do të kishte ndërgjegje dhe vetëdije të lartë politike, që të arrijnë një konsensus të tillë, të gjerë, për një çështje kaq të rëndësishme, siç është dialogu për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Kështu që, ne e mirëpresim një konsensus të tillë, nëse ai buron nga Kuvendi. Mirëpo, nëse një gjë e

tillë nuk ndodhë, atëherë sigurisht që Presidenti i Republikës së Kosovës nuk do ta lë peng një proces të tillë për shkak të divergjencave brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës".

Ndërkaq, Matoshi thotë se më e rëndësishme është arritja e një konsensusi ndërmjet partive politike parlamentare për dialogun me Serbinë sesa çështja se kush do t'i prijë ekipit në dialog. "Nuk është shumë e rëndësishme se kush do t'i udhëheqë bisedimet. E rëndësishme është që të ketë një gjithëpërfshirjedhe në mendojmë se në Ekipin e Unitetit duhet të përfshihet edhe opozita parlamentare". Rreth dy muaj më parë, në një debat të organizuar ndërmjet shefave të grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, ishte kërkuar që legjislativi të ketë rol shumë më aktiv në procesin e dialogut, si dhe për marrëveshjet e arritura me Serbinë. Përfaqësimi politik në dialog, deri më tash, ishte në nivelin e kryeministrave, por në dy takimet e fundit, gjatë këtij viti, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq, kanë përfaqësuar Kosovën dhe Serbinë nga pozitave të presidentëve.

Kosova, barra më e rëndë e Serbisë


Hapja e dy kapitujve të rinj në rrugën e anëtarësimit të Serbisë në Bashkimin Evropian përbën një hap pozitiv drejt anëtarësimit të plotë në BE. Kështu ka deklaruar kryetari i Partisë Liberal Demokratike të Serbisë, Çedomir Jovanović. Ai, gjithashtu, ka deklaruar se është e qartë se problemi i hapur i Kosovës është një barrë në rritje për vendin e tij. Jovanović ka thënë në një deklaratë se mesazhi që kanë marrë në Bruksel sugjeron se, pavarësisht dy kapitujve të hapur, ka pakënaqësi rreth marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës, si rezultat i vonësive në negociata



dhe i mungesës së zgjidhjeve konkrete. Ai beson se presioni i vendeve udhëheqëse në Evropë po rritet për të zgjidhur këto çështje sa më shpejt që të jetë e mundur.

KAPITULLI 30 e detyron Serbinë të shkëputet nga Rusia

Duke hapur Kapitullin 30 të negociatave me BE-në, Serbia praktikisht është obliguar të shkëpusë të gjitha marrëveshjet për tregtinë e lirë, të lidhura me katër shtete: Kazakistanin, Turqinë, Bjellorusinë dhe Rusinë, raportojnë mediat serbe. Por kjo nuk do të jetë e vetmja "sakrificë" e as problemi më i madh për pushtetin në Beograd. Po për shkak të këtij kapitulli Serbia detyrohet të lejojë qarkullimin e prodhimeve GMO (gjenetikisht të modifikuara) në tregun serb, shkruajnë mediat e Beogradit. Shkëputja e marrëveshjeve mund të ketë edhe pasoja politike në marrëdhëniet midis Serbisë e Rusisë, theksojnë analistët



IRANI MBËSHTET "LUFTËN" E HAMASIT



Garda Revolucionare Islamike ofroi "mbështetjen e plotë" të Iranit për militantët palestinezë, në fushatën e tyre të rezistencës kundër vendimit të presidentit amerikan, Donald Trump, për të njohur Jerusalemin kryeqytet të Izraelit

Komandanti Qassem Soleimani, i cili mbikëqyr degën e operacioneve të jashtme të Gardës, u bëri ofertën - në një bisedë telefonike - komandantëve palestinezë të brigadave Xihadi Islamik dhe Izz Al-Deen, që janë krahët e armatosur të grupit militant islamik, Hamasit. Ky i fundit kontrollon Rripin e Gazës. Oferta u bë pasi raketat nga Rripin e Gazës qëlluan Izraelin, ndërsa një u pengua nga sistemi i mbrojtjes raketore, tha ushtria izraelite. Në përgjigje, ushtria e Izraelit tha se ka goditur pozicionet ushtarake të Hamasit me zjarr artilerie. Shkëmbimi i zjarrit midis Izraelit dhe luftëtarëve të Hamasit, prejse Trump ka shpallur vendimin më 6 dhjetor, ka lënë së paku gjashtë palestinezë të vdekur. Shefi i shtabit të ushtrisë iraniane, gjenerali Mohammad Baqeri, tha se "veprimi i pamend" i Trumpit për Jerusalemin mund të shihet si fillim i një kryengritjeje të re palestineze. Ministri i Mbrojtjes i Iranit, Amir Hatami, tha se ky veprim vetëm se "do të nxisë shkatërrimin e regjimit sionist dhe do të dyfishojë unitetin e

myslimanëve". Soleimani, i cili ka komanduar forcat iraniane që kanë luftuar në Siri dhe Irak, tha se grupet e rezistencës në rajon janë të përgatitura për të mbrojtur xhaminë Al-Aqsa të Jerusalemit, vendi i tretë më i shenjtë në Islam. Soleimani është komandant i forcës Kuds të Gardës Revolucionare dhe ka udhëhequr luftën e Iranit kundër grupit ekstremist Shteti Islamik në Irak dhe Siri. Trupat e tij vazhdojnë të ofrojnë mbështetje të rëndësishme për presidentin sirian, Bashar al-Assad, në

luftën e tij kundër rebelëve mysli-manë sunitë. Irani ka kritikuar ashpër vendimin e Trumpit për Jerusalemin dhe ka kërcënuar me pasoja. Presidenti iranian, Hassan Rohani, ka thënë se qyteti i shenjtë është "më shumë sesa thjesht politikë". Vendimi i Trumpit ka shkakuar protesta të mysli-manëve gjithandej në botë, në mbështetje të palestinezëve, të cilët e duan Jerusalemin Lindor kryeqytet të shtetit të tyre të ardhshëm. Trump ka thënë se një vetëm "realitetin" e vendimit

të Izraelit, vite më parë, për të aneksuar Jerusalemin Lindor dhe për ta shpallur gjithë qytetin si kryeqytet të tij. Ky vendim, megjithatë, nuk është njohur më parë nga Shtetet e Bashkuara dhe vazhdon të refuzohet nga shumica e vendeve të tjera. Më 11 dhjetor, grupi militant Hezbollah, aleat i Iranit në Liban, i cili ka bërë luftë me Izraelin në vitin 2006, ka organizuar një protestë në Beirut, në të cilën dhjetëra-mijëra njerëz kanë thirrur "vdekje Amerikës" dhe "vdekje Izraelit".



Kolltuku arab që nuk lëviz

Revolta për vendimin e Presidentit amerikan Donald Trump, për ta njohur Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit është e kufizuar. Ato protesta që shihen në zonat palestineze nuk janë "Intifada e tretë" dhe në vende të tjera "rruga arabe" qëndroi në pjesën më të madhe në shtëpi dhe preferoi "kolltukun arab". Edhe mbledhjen urgjente të ministrave të Jashtëm të Ligës Arabe në Kairo nuk mund ta quash bombë, e cila të linte të kuptojë zemërimin e mbledhur. Bahreini madje e minoi takimin me një delegacion, të cilin Mbretëria e dërgoi në Izrael pikërisht në momentin e takimit. Edhe në Këshillimin e Sigurimit të OKB-së gjithçka mbeti në shprehjen e "zhgënjimit". Askund pra nuk po mblidhet zemërim popullor, as në Iran. Por të gjithëve ua kaloi Presidenti i Turqisë, Rexhep Tayyip Erdogan, i cili bubulloi me fjalët se Izraeli është "shtet terrorist" dhe një "fuqi pushtuese shtypëse". Kjo tregon se sa fort po zhvendosen peshat në botën islame. Regjimeve arabe ka gjasa që aksionizmi i Erdoganit të mos u pëlqejë.

HAPI I SHBA-ve PËR KUDSIN, NJË "SHPALLJE LUFTË"

Sipas imanit të Xhamisë Al-Aksa dhe njëherësh kreut të autoritetit islam të Kudsit, Ekrima Sabri, vendimi i javës së kaluar i administratës amerikane për ta njohur Kuds si kryeqytet të Izraelit është i barabartë me një "shpallje lufte". Duke folur për AA, Sabri pohoi se protestat e fundit në mbarë botën ndaj hapit të SHBA-ve tregojnë se Kuds "nuk i përket vetëm palestinezëve, por të gjithë muslimanëve". Më tej, ai vazhdoi të bëjë thirrje deri te palestinezët dhe banorët e Kudsit që "me çdo kusht" të mbrojnë qytetin e shenjtë. "Arroganca



amerikane nuk do të arrijë asgjë.

Qëndrimi ynë buron nga besimet tona", u shpreh Sabri, duke shtuar se, "Negociatat ose çfarë do lloj i procesit të paqes tani janë jashtë çështjes, sepse SHBA-të tashmë kanë vendosur qëndrimin e tyre mbi Kuds, duke kundërshtuar vetveten dhe duke zgjedhur luftën". Pavarësisht kundërshtimit të gjerë rajonal dhe ndërkombëtar, presidenti i SHBA-ve, Donald Trump, të mërkurën e kaluar njoftoi vendimin e tij për të njohur Kuds si kryeqytet të Izraelit.

Banorët e fshatit kanë bërë të ditur se pas sulmeve ndaj shtëpive të tyre tashmë po sulmohen vendet e shenjta dhe se nuk kanë asnjë mundësi që të pengojnë rrënimet e qeverisë së Mianmarit

RRËNOHEN XHAMITË E ARAKANIT



Autoritetet në zonën Maungdaw në rajonin Arakan të Mianmarit kanë rrënuar 16 xhami. Sipas lajmit të kanalit televiziv "Weekly English News" të cilin e bazon mbi dëshmitarë, autoritetet lokale brenda një jave gjatë fundit të nëntorit dhe fillimit të dhjetorit nga 17 xhami në Maungdaw kanë

rrënuar 16. Banorët e fshatit kanë bërë të ditur se pas sulmeve ndaj shtëpive të tyre tashmë po sul-

mohen vendet e shenjta dhe se nuk kanë asnjë mundësi që të pengojnë rrënimet e qeverisë së

Mianmarit. Ata thonë se mendojnë që edhe xhamia e fundit e mbetur në rajon do të ketë fatin e xhamive të tjera. Ndër të tjera në lajm thuhet se më 7 dhjetor në kampin Pakto ku qëndrojnë muslimanët e Arakanit ka shpërthyer një zjarr për arsye të panjohura dhe nuk ka informacione nëse ka patur apo jo njerëz të vdekur apo të plagosur. Gjithashtu është bërë e ditur se në fshatin Napura forcat e sigurisë së Mianmarit i kanë vënë zjarrin 4 shtëpive të muslimanëve të Arakanit. Më tej thuhet se sendet e vjedhura nga muslimanët e Arakanit po shiten në tregun e qytetit. Fëmijët nuk mund të shkojnë në shkollë, ndërsa është

njoftuar se një vajzë në kampin Balukhali të Bangladeshit ka humbur jetën më 8 dhjetor për shkak të mungesës së përkujdesjes. Ndryshe, mijëra muslimanë të Arakanit kanë humbur jetën që nga 25 gushti e deri më tani si rezultat i sulmeve të ushtrisë së Mianmarit, e cila pretendon se është duke luftuar me militantë të armatosur. Gjatë sulmeve të cilat janë shndërruar në një spastrim etnik janë djegur ose shkatërruar rreth 300 fshatra nga ushtria dhe budistët radikalë, si dhe mbi 600 mijë muslimanë të Arakanit janë larguar në Bangladesh nëpërmjet rrugëve malore, detare apo lumenjve. Parashikohet se rreth 2 milionë muslimanë jetonin në Arakan në vitet 1970, por ky numër ka rënë nën 350 mijë për shkak të largimeve nga sulmet sistematike.

MAGJIA E VALBONËS

E BUKUR DHE JOSHËSE, EDHE NË DIMËR



Valbona, është një sinonim i së bukurës. Edhe rrugët drejt saj, janë një vrapim piktoresk mes malesh. Janë disa rrugë që të çojnë në Valbonë

Turizmi i borës, apo Turizmi i Bardhë, ka nisur. Luginë e Valbonës e ka prishur bardhësinë e saj nga skiatorët dhe gjurmët e vizitorëve të fundjavës. Valbona të emocionon në çdo stinë, edhe tani në fillimdimri, ajo ka marrë një tjetër nur. Ka hequr petkun e gjelbër dhe është veshur me të bardha. Ajo është një kompleksitet dukurish interesante, ashtu siç janë vet Alpet Shqiptare.

Në çdo stinë, Valbona, është një sinonim i së bukurës. Edhe rrugët drejt saj, janë një vrapim piktoresk mes malesh. Janë disa rrugë që të çojnë në Valbonë, port ë gjitha lidhen me malet. Ajo përmes luginës së Komanit që përfundon në Fierzë e mandej në Valbonë, kalon mes ujit dhe maleve. Një tjetër lidhet me Rrugën e



Kombit, nga Tropoja e Vjetër e në Valbonë, nga Prizreni, por dhe nga Qafë-Mali kur nuk ka borë. Të gjitha të çojnë drejt së bukurës Valbonë.

E kthyer në një oazë çlodhës dhe përkëdhelës për të gjithë, në lartësinë e 800 metrave mbi nivelin e detit, në këto ditë dimri që të zgjojnë shijen e dimrit me dëborë

kudo në luginën e Valbonës, turistët i janë ofruar bukurive të bardhësisë së. Tashmë, turizmi aty është kthyer në biznesin më fitimprurës për banorët e kësaj zone, ku vazhdon të ruhet me fanatizëm mënyra e jetesës, ku tradicionalja vazhdon të mos preket, duke rritur interesin e të huajve dhe vendasve.

Në Valbonë ka hotele moderne dhe shtëpi bujtina që presin vizitorët. mbi 20 hane që u shërbejnë turistëve në çdo stinë të vitit. Ndoc Mulaj, natyralisti dhe miku i mjedisit, raporton se bora tashmë ka shtruar në luginë dhe ka boll vizitor që kanë mbërritur aty. Gjatë ditës organizohen piknik bjeshkëve, duke soditur

majat e mbuluara me borë dhe duke shijuar ushqimet karakteristike të zonës të përgatitura për periudhën e dimrit, si pastërma, gështenja të ziera ose të pjekura (porogaça), e deri te turshitë karakteristike, domate, tranguj, speca, lakra e salcë kosi, duke mos harruar pijen tradicionale, rakinë e rrushit dhe të kumbullës. Valbona është e bukur dhe mikpritëse në çdo stinë dhe vizitohet në çdo kohë.

(Telegrafi)

NUK ËSHTË ZVICRA, JANË MALET E DIBRËS QË TË LËNË PA FRYMË

Këto pamje duhet t'i shkelësh me këmbë e t'i shohësh me sy, vetëm kështu e kupton se sa e bukur është Shqipëria. Sidomos aty ku dora e njeriut ka vepruar pak. Qarku i Dibrës është vizituar nga rreth 10 mijë vizitorë këtë vit, nga të cilët 3500 janë turistë të huaj – thotë drejtori i Administratës së Zonave të Mbrojtura të Qarkut Dibrë, Bekim Qosja.

Dibra është një bazë e mirë për

turistët e malit që dëshirojnë majat e vërteta shkëmbore, aventurën, frikën dhe kënaqësinë. Dibra shtrihet në veri-lindje të Shqipërisë, në anën lindore të luginës së Drinit të Zi, duke u kufizuar në lindje nga vargmali i Korabi dhe në perëndim nga vargmalet e Lurës. Shijojini këto pamje në foto, ndërsa për më guximtarët është mirë t'i japin vetes një mundësi për t'i vizituar fizikisht këto anë.



MË SHIRITIN E KOHËS

“PEARL HARBOR”, SULMI QË NDRYSHOI FATIN E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

8 dhjetori i vitit 1941 shënoi një pikë kthese në jetën e kombit amerikan. Amerika jo vetëm që kishte hyrë në luftë atë ditë, por kishte hyrë njëkohësisht edhe në një marrëdhënie të re botërore

I shte 7 dhjetori i 1941. Ditë e siel. Zëri i radios thyente qetësinë e mbrëmjes, duke dhënë një lajm të papritur dhe tronditës. Një valë prej 189 avionësh luftarakë japonezë kishin sulmuar papritur bazën ushtarake detare në Pearl Harbor. 170 aeroplanë amerikanë ishin shkatërruar pa arritur të ngriheshin në ajër. 19 anije luftarake amerikane kishin dalë jashtë përdorimit, 2400 oficerë të vrarë dhe 300 të tjerë të plagosur. Ishte katastrofa më e madhe që kishte ndodhur ndonjëherë në historinë e forcave të armatosura të Amerikës.

Lajmi u dëgjua nga një milion familje amerikane. Qytetarët amerikanë u shokuan. Lajmi i tmerrshëm vazhdoi të përsëritej tërë atë pasdite dhjetori deri natën vonë. Shpërndarësit e gazetave nëpër rrugë thërrisnin: Ekstra! Ekstra! Gazetat shpërndanin lajmin tek ata që nuk e kishin dëgjuar në radio. Të nesërmen në orën 12.30 të pasdites Shtetet e Bashkuara dhanë përgjigjen e tyre. Kur presidenti Delano Roosevelt u shfaq në hyrjen e sallës së kongresit, të

gjithë vunë re shenjat e një nate të gjatë, tronditëse. Hyrja e tij në sallë u pasua nga duartrokitje të menjëhershme dhe thirrje.

Ata u përkisnin partive të ndryshme, opozitare me njëra tjetrën. Deri dje disa e kishin mbështetur presidentin në politikën e tij, të tjerë e kishin kundërshtuar. Me sulmin japonez, të gjitha diferencat u zhdukën njëherësh. Ata u radhitën të bashkuar pas presidentit të tyre. Presidenti ishte simboli i fuqisë së SHBA, përfaqësuesi i kombit të tyre. Presidenti Ruzvelt duke folur për ngjarjen e një dite më parë tha: “Sulmi i djeshëm mbi ishujt Hauaji i ka shkaktuar një dëm të madh flotës amerikane dhe forcave të armatosura. Shumë amerikanë humbën jetën e tyre.

Shumë anije amerikane u bombarduan midis San Franciskos dhe Honolulu... Besoj që shpreh vullnetin e Kongresit dhe të popullit amerikan kur deklaroi që ne jo vetëm do të mbrojmë veten tonë por do të sigurojmë që ky rrezik të mos kanoset më në të ardhmen. Me besim në forcat tona të armatosura, me vendosmërinë e patun-

dur të popullit tonë, ne do të triumfojmë... Unë i kërkoj Kongresit të deklarojë gjendjen e luftës me Japoninë duke filluar që nga 7 dhjetori 1941, ditën e diel.” Përgjigja e Kongresit që e menjëhershme. Për herë të parë, pas një çerek shekulli, populli amerikan u bashkua me një qëllim të vetëm: për të mbrojtur Amerikën dhe jetën e qytetarëve të saj.

8 dhjetori i vitit 1941 shënoi një pikë kthese në jetën e kombit amerikan. Amerika jo vetëm që kishte hyrë në luftë atë ditë, por kishte hyrë njëkohësisht edhe në një marrëdhënie të re botërore. Dita e sulmit të përgjithshëm mbi Gjermaninë naziste që hyri në histori me emrin e koduar “D-Day”, u realizua në 6 qershor 1944. Kryekomandanti i forcave aleate që gjenerali amerikan Dwight Eisenhower. Në frontin e brendshëm e gjithë ekonomia e vendit u vu në dispozicion të një qëllimi të vetëm: mundjes së boshtit Gjermani-Itali-Japoni. Amerika ishte e bashkuar për të luftuar armikun në dy fronte, në Evropë dhe në Azi. Meqenëse burrat e djemtë shkuan


në luftë, gratë e vajzat zëvendësuan ata në frontin e brendshëm. Ato treguan aftësi të mëdha në përballimin e situatës, rritjen e prodhimit e ndërkohë personaliteti i tyre u rrit si asnjëherë.

Bashkë me forcimin e frontit të brendshëm, qeveria ishte vigjilente ndaj veprimit të spiunazhit japonez në vend, veçanërisht në bregun perëndimor. Në 1942 Presidenti lëshoi një urdhër ekzekutiv (Executive Order 9066) duke ia kaluar kompetencat e sigurimit ushtrisë. Komandanti i ushtrisë për bregun perëndimor të vendit, gjenerali John De Witt urdhëroi zhvendosjen (internimin) e 127 000 japonezo-amerikanëve për sa kohë që do të zgjaste lufta. Mijëra burra, gra e fëmijë japonezë u nxorën nga shtëpitë e tyre e u mbajtën në kampe përqendrimi në kushte burgu për tri vjet. Tre të katërtat e atyre ishin fëmijë të lindur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, domethënë ishin shtetas amerikanë. Qeveria amerikane kërkonte të mbronte me çdo kusht qytetarët e saj edhe pse ky akt binte në kundërshtim me kushte-

tutën. Gjykata e lartë e mbështeti urdhrin e presidentit. Në vitin 1988 qeveria amerikane kërkoi falje për këtë veprim të asaj kohe dhe u dha 20 mijë dollarë si dëmshpërblim qytetarëve japonezë që mbijetuan nga kampet e internimit.

Lufta e Dytë Botërore ka qenë lufta më e kushtueshme në historinë e Amerikës. Deri atë kohë. Amerika shpenzoi në këtë luftë mbi 550 bilion dollarë. Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore me fitoren e aleatëve, bëri që Frenklin Rusvelti të zgjidhej për të katërtën herë president i SHBA. Madje edhe armiq të tij politikë e pranuan me qetësi triumfin e tij. Sidoqoftë fundi i luftës e gjeti presidentin të lodhur. Edhe pse ishte vetëm 63 vjeç ai dukej më i rënë në moshë. Në Warms Springs në prillin e vitit 1945, i rrethuar nga pranvera presidentit iu afrua vdekja. Në 12 prill 1945 miliona amerikanë qanë për vdekjen e presidentit të paharruar, Frenklin Delano Ruzveltsi sikur të ishte njeri i familjeve të tyre.

(Marrë nga libri “Udhëtim në historinë Amerikës” i shkrimtares Albana M. Lifschin)





REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nënpusëve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16“) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 90/15“), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16“) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15“), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 38/2017

për punësimin e 1 nëpunësve publik nga grupi I, nëngrupi II në „Institucion publik komunal për fëmijë - Çerdhen e Fëmijëve „Detska Radost“ - Strumicë“ për vendet e punës në vijim:

1. DEZ0102V04001 Bashkëpunëtor i ri - sekretar. 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat juridike.
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arrijtje të rezultateve
- puna me të tjerët/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombëtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFRL, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Geta.
- Njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohej edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG I+I+I+I+

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 19.998,00 denarë

VËREJTJE:

Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Maqedonas(e) 1. Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faja e internetit e Agjencisë. Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Faza e 4 – të: Testi i personalitetit realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të fazës së 3 – të.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr 167/2015, 27/2016) dhe nenit 5, 7, 8 dhe 9 të Marrëveshjes kolektive të SHA Elektranat e Maqedonisë, në pronësi të shtetit Shkup, ndërsa në lidhje me Vendimin për nevojën për lidhje të marrëdhënies së punës nr. 02-6852/3 të datës 11.12.2017

SHA ELEKTRANAT E MAQEDONISË – SHKUP

publikon
SHPALLJE PUBLIKE

Për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës në Drejtorinë e SHA ELEM – Shkup, për realizimin e punëve për kohë të pacaktuar, për vendin e punës në vijim:

- 1 (një) realizues në vendin e punës “Shef i kabinetet” në Kabinetin e drejtorit të përgjithshëm.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla VII, Arsim sipëror profesional, 3 vjet përvojë pune dhe njohje të gjuhës angleze.

Shuma në të holla e pagesës bazë është 49.186 denarë.

- 1 (një) realizues në vendin e punës “Sekretar teknik i drejtorit të përgjithshëm”, në Kabinetin e drejtorit të përgjithshëm.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla IV, Arsimiti i mesëm, 1 vjet përvojë pune, njohje të gjuhës angleze dhe punës me kompjuter.

Shuma në të holla e pagesës bazë është 31.421 denarë.

Java e punës është 5 (pesë) ditë pune, nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, ndërsa gjatë ditëve të punës do të zgjasë 8 orë në ditë edhe atë me fillim prej ora 07:30 – 08:00 deri më 15:30 – 16:00.

Shpallja zgjatë pesë ditë pune nga dita e shpalljes.

Së bashku me fletëparaqitjen (të shkruar me dorë) në të cilën theksohet se për cilin vend pune konkurrohet, kandidatët duhet të parashtrijnë:

- Dëshmi për arsimin e mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuara në noter);
- Dëshmi për përvojën e punës (listë nga SPIM);
- Certifikatë të shtetësisë (kopje);
- Biografi të shkurtër në gjuhën maqedonase;
- Kontakt telefon.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitja me dokumentet e nevojshme, nga të cilat shihet se kandidati i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të posaçme, të dorëzohen në adresën:

SHA Elektranat e Maqedonisë - Shkup, Drejtoria

rr. 11 Oktomvri nr. 9, Shkup, (me shenjë “për shpallje publike”).

SHAELEM – SHKUP



IPSH ENTI GERONTOLOGJIK – 13 NOEMVRI – SHKUP

rr. 4 juli 129 Shkup; tel. ++389 2 2031-238; faks: ++389 2 2041-461; e-mail: info@gerontology.org.mk
BDS 4063902 NTP 4030997139926

Në bazë të nenit 156,157,158,159 dhe 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16). Kumesës së Ministrisë së financave të RM nr. 18-7080/2 të datës 03.08.2017 për shpallje si të vlefshme (Pëlqimin për njetet e siguruar financiare për punësimet të dhënë nga ana e Ministrisë së financave me numër 18-70975/2 të datës 01.08.2016 për nevojat e IPSH Enti Gerontologjik “13 Noemvri” – Shkup shpalllet si të vlefshme në pjesën në të cilën nuk është realizuar edhe gjatë vitit aktual 2017) dhe Vendimit për publikim të serishëm të Shpalljes nr. 03-3197 të datës 11.12.2017 nga ana e U. D Drejtorit të IPSH Enti Gerontologjik “13 Noemvri” – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësimin e punëtorëve shëndetësor, një (1) Doktor të medicinës dhe dy (2) motra medicinale për kohë të pacaktuar.

1. IPSH Enti Gerontologjik “13 Noemvri” – Shkup ka nevojë për punësimin e punëtorëve shëndetësor një (1) doktor të medicinës për punë në Repartin Hospis Sju Rajder – Manastir dhe dy (2) motra medicinale për punë në Shkup për kohë të pacaktuar.

2. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore;
- Të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për realizim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

3. Përpos me ligj të vërtetuara kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për Doktor të medicinës duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Arsim të mbaruar sipëror (VII/1) ose 240 kredi sipas SETK – Fakulteti i medicinës,
- Provim të dhënë profesional
- Licencë për punë
- Njohje të një prej gjuhëve të huaja botërore (angleze, frënge, gjermane)
- Njohje të punës me kompjuter
- Me dhe pa përvojë pune

4. Orari javor i punës është 40 orë – me ndërrime, neto pagesa bazë për Doktor të medicinës është 26.583,00 denarë.

5. Përpos me ligj të vërtetuara kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për Motër medicinale duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Arsim të mesëm të medicinës motër medicinale (PMP – shkalla IV)
- Provim të dhënë profesional
- Me dhe pa përvojë pune

6. Orari javor i punës është 40 orë – me ndërrime, neto pagesa bazë për Motër medicinale është 16.814,00 denarë.

7. Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët për Doktor të medicinës janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- Biografi të shkurtër (CV)
- Diplomë me sukses mesatar (nëse është marrë jashtë vendit të nostrifikuar nga Ministria e arsimit)
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
- Certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter

- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter

- Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter

- Dokument për njohje të një prej gjuhëve botërore (angleze, frënge, gjermane), origjinal ose kopje të vërtetuara në noter

- Dokument për njohje të punës me kompjuter, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter

- Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter

- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

8. Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët për Motër medicinale janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt

- Biografi të shkurtër (CV)

- Diplomë me sukses mesatar apo certifikatë/dëftesa për arsim të mbaruar nga të gjitha vitet, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter

- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter

- Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter

- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

9. Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve është 7 (shtatë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes.

10. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.

11. Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur të cilët i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provimi kualifikues në pajtim me nenin 160 paragrafi 3 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

12. Fletëparaqitja me dokumentacionin e përgjithshëm dhe telefonin për kontakt, të dorëzohet në Arkivin e IPSH Enti Gerontologjik “13 Noemvri” – Shkup prej ora 08-15,00 ose përmes postës në adresën “ 4 Juli” nr. 129 – Shkup, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Enti Gerontologjik “13 Noemvri” – Shkup

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune- Tekst i konsoliduar (“Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë” nr. 145/2014), dhe miratimi nga Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë nr. 12-11813/2 prej 06.12.2017, u.d. drejtori i SHF „Vëllezërit Ramiz-Hamid“ komuna Shuto Orizari-Shkup shpall:

KONKURS PUBLIK

për punësimin e kuadrit mësimit dhe jomësimit për vitin shkollor 2017/2018 për një kohë të caktuar deri më 31.08.2018

- Arsimtarë i grupit klasor -9 realizues me 20 orë mësimore me neto pagesë prej 20.644,00 denarë.
- Arsimtarë i gjuhës angleze - 4 realizues me 20 orë mësimore me neto pagesë prej 20.644,00 denarë.
- Arsimtarë i artit figurativ- 1 realizues me 4 orë mësimore me neto pagesë prej 4.013,00 denarë.
- Arsimtarë i kulturës klasike në civilizimin evropian- 1 realizues me 18 orë mësimore me neto pagesë prej 18.580,00 denarë.
- Arsimtarë i gjuhës gjermane -1 realizues me 20 orë mësimore me neto pagesë prej 20.644,00,00 denarë.
- Arsimtarë i informatikës -2 realizues me 20 orë mësimore me neto pagesë prej 20.644,00 denarë.
- Arsimtarë i gjeografisë-1 realizues me 10 orë mësimore me neto pagesë prej 10.032,00 denarë.
- Arsimtarë i gjuhës dhe kulturës të romëve- 4 realizues me 20 orë mësimore me neto pagesë prej 20.644,00 denarë.
- Arsimtarë i gjuhës dhe kulturës të romëve -1 realizues me 12 orë mësimore me neto pagesë prej 12.386,00 denarë.
- Arsimtarë i gjuhës dhe kulturës të romëve -1 realizues me 12 orë mësimore me neto pagesë prej 12.386,00 denarë.
- Arsimtarë i gjuhës maqedonase -1 realizues me 8 orë mësimore me neto pagesë prej 8.026,00 denarë.
- Arsimtarë i artit figurativ -1 realizues me 8 orë mësimore me neto pagesë prej 8.026,00 denarë.
- Defektolog -1 realizues me 40 orë mësimore me neto pagesë prej 20.644,00 denarë.
- Arsimtarë i edukatës muzikore - 1 realizues me 13 orë mësimore me neto pagesë prej 13.042,00 denarë në zëvendësim deri në kthim të punëtorit.
- Arsimtarë i projektit të artit muzikor - 1 realizues me 7 orë mësimore me neto pagesë prej 7.022,00 denarë
- Arsimtarë i gjuhës maqedonase -1 realizues me 20 orë mësimore me neto pagesë prej 20.644,00 denarë.
- Arsimtarë i fizikës -1 realizues me 12 orë mësimore me neto pagesë prej 12.386,00 denarë.
- Arsimtarë i matematikës-1 realizues me 20 orë mësimore , me neto pagesë prej 20.644,00 denarë.
- Arsimtarë i biologjisë-1 realizues me 20 orë mësimore , me neto pagesë prej 20.644,00 denarë.
- Arsimtarë i shkencave natyrore -1 realizues me 14 orë mësimore , me neto pagesë prej 14.045,00 denarë.
- Arsimtarë për inovacion -1 realizues me 7 orë mësimore, me neto pagesë prej 7.022,00 denarë.
- Arsimtarë i aftësive për jetesë -1 realizues me 14 orë mësimore, me neto pagesë prej 14.045,00 denarë.
- Arsimtarë i edukatës fizike dhe arsimit shëndetësor - 1 realizues me 13 orë mësimore, me neto pagesë prej 13.419,00 denarë.
- Arsimtarë i gjuhës angleze -1 realizues me 17 orë mësimore, me neto pagesë prej 17.054,00 denarë
- Arsimtarë i matematikës - 1 realizues me 12 orë mësimore, me neto pagesë prej 12.386,00 denarë
- Arsimtarë i fizikës -1 realizues me 10 orë mësimore, me neto pagesë prej 10.322,00 denarë
- Arsimtarë i biologjisë -1 realizues me 6 orë mësimore, me neto pagesë prej 6.019,00 denarë
- Arsimtarë i shkencave natyrore -1 realizues me 20 orë mësimore, me neto pagesë prej 20.644,00 denarë
- Arsimtarë i kimisë-1 realizues me 20 orë mësimore, me neto pagesë prej 20.644,00 denarë
- Arsimtarë i edukatës fizike dhe arsimit shëndetësor -1 realizues me 20 orë mësimore, me neto pagesë prej 20.644,00 denarë
- Arsimtarë i arsimit qytetar - 1 realizues me 15 orë mësimore, me neto pagesë prej 15.048,00 denarë
- Arsimtarë i etikës - 1 realizues me 5 orë mësimore, me neto pagesë prej 5.016,00 denarë

Orari i punës i kuadrit mësimit është në dy ndërrime dhe ata ndërrimi i parë prej ora 07.00 deri në ora 13.00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.00 deri në ora 19.00 nga e hëna deri të premten, i ndarë sipas programit arsimor dhe orarit të orëve të arsimtarëve.

Orari i punës i defektologut është ndërrimi i parë prej ora 07.00-15.00 prej të hënës deri të premten. KUSHTET: Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e parapara në Ligjin për marrëdhënie pune, ndërsa kuadri mësimit duhet të plotësojë kushtet e veçanta të parapara në nenin 77 dhe nenin 80 nga Ligji për arsim fillor si dhe Normativin për kuadër mësimit në arsimin fillor.

Më lutjen kandidatët duhet të dorëzojnë diplomë apo vërtetim për arsim të kryer përkatës dhe certifikatë të shtetësisë (origjinal apo kopje e notuarizuar).

Dokumentet e pakompletuara apo të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Lutjet me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen deri te SHF “Vëllezërit Ramiz-Hamid” - komuna Shuto Orizari Shkup, rr. Che Gevara nr. 80 Shkup, tel. 2654-040

Konkursi zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Përzgjedhja do të bëhet në afat prej 45 ditë prej skadimit të afatit për aplikim.

U. D Drejtor
Alvin Salimovski

PËRFUNDON SEZONI VJESHTOR PËR ADILIN DHE UTA ARAD

I KËNAQUR ME PARAQITJET, POR JO EDHE ME REZULTATET



Tare i tërbuar me VAR-in

Igllj Tare shpërthen ndaj gjykimet dhe mënyrës sesi përdoret sistemi VAR në ndeshjet ku luan Lacio. Drejtori Sportiv i bardhekaltërve kërkon llogari për episodet, që penalizuan skuadrën kryeqytetase në humbjen 1-3 me Torinon.

“Kërkojmë sqarim. Ky ishte një skandal. Lacio është dëmtuar hapur, kërkojmë respekt. Gjatë sezonit mund të ndodhin 1 apo 2 gabime, por tani është kthyer në zakon. Kemi mbërritur deri këtu pa “vjedhur” asgjë. Duam të jemi zotë të fatit tonë, pa ndikuar askush te rezultatet. Duam sqarim në interpretimin e disa episodeve”, u shpreh Tare. Më pas ai Tare ndalet te momentet e veçanta të ndeshjes. E nisim nga 11-metërshi. Nëse kemi nevojë për VAR-in, atëherë le ta përdorim. Ishte një faull i qartë me dorë, ishte 11-metërsh, që duhej akorduar. Përkundrazi, VAR-i u përdor vetëm për një kontakt të Immobiles me Burdison, për një episod që vetë mbrojtësi argjentinas e pranoi se nuk ishte prekur. Tani duhet të ruajmë qetësinë në një moment të vështirë, sepse kishim një mundësi të madhe. Do të jemi më të fortë se fati”, deklaroi Tare. Cekim, pas 16-të javëve Lacion gjendet në pozitën e pestë me 32 pikë, tre më pak se pozita e katërt e cila qon në Ligën e kampionëve.



“Mendoj se ky rezultat i dobët vjen pas ndryshimeve të ndodhën në ekip. Kemi ndërruar tre trajner, diku 12 lojtar janë larguar kurse kanë ardhur shumë lojtar të ri, kështu që mendoj se kjo është arsyeja kryesore se pse gjendemi në këtë situatë”, pohon Adili, i cili nëse jo me rezultatet e skuadrës, thotë se është i kënaqur nga paraqitjet e tij



90-të për qind të ndeshjeve i kam zhvilluar, ndërsa kam shënuar një gol dhe kam bërë tre asistime. Jam shumë i kënaqur për paraqitjet që i kam bërë, ndërsa të kënaqur kanë mbetur edhe stafi teknik dhe trajneri. Sinqerisht gëzoj një respekt të madh nga të gjithë por edhe tifozët të cilët vlerësojnë shumë paraqitjet e mia dhe kontributin që e jap për skuadrën e tyre të zemrës

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 12 dhjetor – Ka përfunduar sezoni vjeshtor në Ligën e dytë të Rumanisë, ndërsa skuadra e UTA Arad, pjesë e së cilës është futbollisti shqiptar Mevlan Adili ka përfunduar në pozitën e 12-të. Një rezultat aspak i pritur duke marr parasysh ambiciet e klubit para sezonit, ku ata synonin plasmanin në elitën e futbollit vendor. Ndryshe, me të përfunduar sezoni vjeshtor, Adili pushimin e merituar po e shfrytëzon në vendlindjen e tij, ndërsa për gazetën KOHA, ka folur për rezultatet e arritura, paraqitjet e dhe të ardhmen e tij. “Aspak nuk jemi të kënaqur me rezultatet e arritura këtë sezon. Në fillim të sezonit ambiciet tona ishin plasmani në Ligën e parë, ndërsa aktualisht jemi në po-

zitën e 12-të me vetëm 25 pikë të grumbulluara dhe larg vendit të parë dhe të dytë 24 respektivisht 23 pikë. Mendoj se ky rezultat i dobët vjen pas ndryshimeve të ndodhën në ekip. Kemi ndërruar tre trajner, diku 12 lojtar janë larguar kurse kanë ardhur shumë lojtar të ri, kështu që mendoj se kjo është arsyeja kryesore se pse gjendemi në këtë situatë”, pohon Adili, i cili nëse jo me rezultatet e skuadrës, thotë se është i kënaqur nga paraqitjet e tij. “90-të për qind të ndeshjeve i kam zhvilluar, ndërsa kam shënuar një gol dhe kam bërë tre asistime. Jam shumë i kënaqur për paraqitjet që i kam bërë, ndërsa të kënaqur kanë mbetur edhe stafi teknik dhe trajneri. Sinqerisht gëzoj një respekt të madh nga të gjithë por edhe tifozët të cilët vlerësojnë

shumë paraqitjet e mia dhe kontributin që e jap për skuadrën e tyre të zemrës”, nënvizoi më tej mbrojtësi i talentuar. Ndërkohë, pjesë e skuadrës rumune Adili është nga muaji janar, ndërsa deri në përfundim të kontratës i kanë mbetur edhe gjashtë muaj. “Kam edhe gjashtë muaj kontratë, por nuk e di a do të vazhdojë të qëndrojë te UTA Arad apo do të largohem. Sinqerisht njëherë dua të pushoj dhe më pas do të vendos se çka do të bëj. Kuptohet kjo punë është e menaxherit tim Meriton Berisha dhe bashkërisht do të vendosim për të ardhmen time. Atë që dua të them edhe njëherë është se te UTA jam shumë i lumtur dhe gëzoj respekt të madh nga të gjithë”, përfundoi deklaratën e tij për gazetën KOHA, Mevlan Adili.

PËR SHKAK TË MINUTAZHIT TË VOGËL

Maksuti largohet nga Llapi



Shkup, 12 dhjetor – Vala Superliga e Kosovës e ka mbyllur pjesën e parë të sezonit dhe tashmë klubet janë të fokusuar te merkatoja, si në hyrje ashtu dhe në dalje. Aktualisht vendin e parë e mban skuadra e Llapit, që ka grumbulluar 34 pikë, ndërkohë që e ndjek skuadra e Prishtinës, por duhet thënë se në garë për titull janë disa ekipe. Së fundmi mësohet se nga Llapi janë larguar dy futbollistë, të cilët kanë ndërprerë marrëveshjet me skuadrën kryesuese. Në mesin e tyre është sipas “gazeta olle” është edhe futbollisti teto-

var Miran Maksuti. Derisa këtë lajm për gazetën KOHA e konfirmoi edhe vet Maksuti. “Është e vërtetë se më nuk jam futbollist i Llapit. Kisha edhe gjashtë muaj kontratë, por shkak që trajneri nuk më jepte rast të luaj, me kryesinë e klubit rram dakord që të ndërpresim bashkëpunimin dhe largohen. Vetëm dy ndeshje arrita të luaj dhe shënova dy gola, pjesën tjetër e kam kaluar në bankë”, pohon Maksuti. Sulmuesi shtatllartë thotë se ka marr oferta nga klubet tjera kosovare por edhe ato nga kampionati vendor, mirë-

po ende nuk ka vendosur se ku do të vazhdojë karrierën. “Aktualisht jam në pushime në Zvicër. Kam marr disa oferta nga Kosova dhe Maqedonia, mirëpo ende nuk kam vendosur se ku do të vazhdojë karrierën. Do të shqyrtoj mirë se cila oferta është më e mirë dhe atë do ta pranoj”, deklaroi për gazetën KOHA, Maksuti. Cekim, me skuadrën kosovare Maksuti ishte bashkuar në qershor kur u transferua nga skuadra daneze Herlev, ndërsa në të kaluarën ai ka qenë edhe pjesë e FC Shkupi dhe “Dritës” nga Bogovina. (B.K.)

TEST ZJARRI PËR FUTBOLLIN SPANJOLL

PO KËRCËNOHET HEGJEMONIA E TIJ NË ÇAMPIONS?



Për herë të parë në katër vitet e fundit, hegjemonia e ekipeve të La Liga-s në Ligën e Kampionëve duket të jetë në diskutim. Në pesë sezonet e fundit kanë qenë gjithmonë të paktën tri skuadra spanjolle në çerekfinale, një shifër që duket më e vështirë për t'u arritur këtë kohë

Real Madridi, Barcelona dhe Sevilja do të duhet të tregojnë versionin e tyre më të mirë për të qenë në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Me Atletico Madrid të eliminuar tashmë, tre përfaqësuesit spanjollë në konkurrencën e lartë kontinentale për klubet janë "çiftëzuar" në shortin e 1/8 finale me rivalë të vështirë: PSZH për Real Madridin, Çellsit për Barcelonën dhe Mançester Junajtedi për Seviljën.

Për herë të parë në katër vitet e fundit, hegjemonia e ekipeve të La Liga-s në Ligën e Kampionëve duket të jetë në diskutim. Në atë periudhë, Real Madridi ka shtuar tre tituj dhe një Barcelona. Përveç kësaj, Atletico Madridi ka qenë finalist dy herë. Sikur kjo të mos ishte e mjaftueshme, të bardhët kanë shtatë gjysmëfinale të njëpasnjëshme dhe Barça ka luajtur

shtatë të tilla në dhjetë vitet e fundit. Do të ishte e nevojshme të ktheheshim dymbëdhjetë vite në kohë për të gjetur vendet e Çampionit pa praninë e ekipeve spanjolle. Në sezonin 2004-2005, Barcelona ra në raundin e dytë kundër Çellsit dhe Real Madridi bëri të njëjtën gjë kundër Juventusit. Në pesë sezonet e fundit kanë qenë gjithmonë të paktën tri skuadra spanjolle në çerekfinale, një shifër që duket më e vështirë për t'u arritur këtë kohë.

JA BILANCI I EKIPEVE SPANJOLLE NË TETËSHE TË ÇAMPIONSIT

Çampions 2016-2017: Real Madridi, Barcelona, Atletico Madrid dhe Sevilja në tetëshe. Ata janë kualifikuar: Real Madridi kundër Napolit, Barça kundër PSZH-së dhe Atletico Madrid kundër Le-

verkuzenit, minus Sevilja, që dështoi kundër Leicester.

Çampions 2015-2016: Real Madrid, Barcelona dhe Atletico Madrid në tetëshe. Ata janë kualifikuar: Real Madrid kundër Romës, Barcelona kundër Arsenalit dhe Atletico Madrid kundër PSV.

Çampions 2014-2015: Real Madridi, Barcelona dhe Atletico Madrid në tetëshe. Ata janë kualifikuar: Real Madrid kundër Schalke 04, Barcelona kundër Mançester Sinit dhe Atletico Madrid kundër Leverkusenit.

Çampions 2013-2014: Barcelona, Atletico Madrid dhe Real Madridi në tetëshe. Ata janë kualifikuar: Barça ndaj Mançester Siti, Atletico Madrid ndaj Milanit dhe Real Madrid kundër Schalke 04.

Çampions 2012-2013: Valencia, Real Madridi, Malaga dhe Bar-

celona në tetëshe. Kjo ndodhi kështu: Real Madridi kundër Mançester Junajtedit, Malaga ndaj Portos dhe Barcelona ndaj Milanit. Valencia ra para PSZH-së.

Çampions 2011-2012: Barcelona dhe Real Madridi në tetëshe. Të dy u kualifikuan ndaj Leverkusenit dhe CSKA Moskës, respektivisht.

Çampions 2010-2011: Valencia, Barcelona dhe Real Madridi në tetëshe. Ata u kualifikuan kundër Lionit dhe Arsenalit, respektivisht. Valencia u eliminua nga Schalke 04.

Çampions 2009-2010: Real Madridi, Barcelona dhe Sevilja në tetëshe. Eliminohet Real Madridi kundër Lionit dhe Sevilja kundër CSKA, kalon vetëm Barça kundër Shtutgart.

Çampions 2008-2009: Barcelona, Atletico Madrid, Real Madridi dhe Vilareali në tetëshe. Eliminohet Atletico Madrid kundër Porto dhe Real Madridi kundër Li-

verpulis. Kualifikohet Barça kundër Lionit dhe Villarreali kundër Panatinaikos.

Çampions 2007-2008: Real Madridi, Sevilja dhe Barcelona në tetëshe. Eliminohet Real Madridi kundër Romës dhe Sevilja kundër Fenerbahçes. Kualifikohet vetëm Barça kundër Seltit.

Çampions 2006-2007: Real Madridi, Valencia dhe Barcelona në tetëshe. Eliminohet Real Madridi kundër Bajern Muniut dhe Barcelona kundër Liverpoolit. Kalon vetëm Valencia kundër Interit.

Çampions 2005-2006: Real Madridi, Villarreali dhe Barcelona në tetëshe. Eliminohet Real Madridi kundër Arsenalit. Kalon Barça kundër Çellsit dhe Villarreali kundër Ranxhers.

Çampions 2004-2005: Real Madridi dhe Barcelona në tetëshe. U eliminuan të dyja skuadrat: Real Madridi kundër Juves dhe Barça kundër Çellsit.

Maradonën e lënë pa fjalë në Indi!



Diego Armando Maradona ishte i ftuar në Kalkuta të Indisë, por mbeti i befasuar. Argjentinasi u ftua për të përruar statujën e tij prej bronzi, tre metra të lartë, që kujton momentin kur El Pibe de Oro ngriti lart Kupën e Botës në vitin 1986 në Meksikë. Por sikurse në rastin e statujës së Kristiano Ronaldos, lë shumë vend për diskutim ngjashmëria e veprës me pamjen e atëhershme të legjendës së futbollit. Vetëm Maradona, i ftuar për të zbuluar këtë statujë, u surprizua kur e pa për herë të parë. Komentet në rrjetet sociale kanë qenë të shumta,

pasi vënë në diskutim cilësinë e portretit të Maradonës. Ndryshe, për miliona anembanë globit, Diego Maradona është futbollisti më i madh që ka vendosur këmbë në planetin. Shumica e tyre madje e konsiderojnë atë si 'zot të futbollit'. Por, legjenda, megjithatë, nuk e mban veten në një nderim kaq të lartë. "Unë nuk mendoj se unë jam 'zot i futbollit', unë e konsideroj veten thjesht një lojtar futbollit", tha Maradona. "Unë jam i kënaqur që jam në Kalkuta për herë të dytë. Faleminderit shumë për dashurinë", deklaroi Maradona.

Salgado: Ronaldo është shpirti i Realit

Miçel Salgado lëviz në rezidencën e tij në Dubai. Ai, që ishte pjesë e Real Madridit, e pa të qartë që nga fillimi dhe u vendos në Emirates, duke kërkuar vendin e vet në futboll. Ai ka folur për Benzema dhe Kristiano Ronaldo, lojtarë të cilët janë shënjuar nga mungesa e golave në këto javë të La Liga-s:

"Ju nuk mund ta kritikoni Ronaldon. Kristiano është shpirti i Real Madridit. Kur është në fushë, e shihni sa frikësues është për rivalët e tjerë. Kjo është e mirë. Kristiano është shembulli i përsosur i asaj që është Real Madridi. Ky ekip punon dhe merr frymë si Ronaldo. Kur të vijë momenti i së vërtetës, ai shfaqet. Është si

Marselo, i cili gjithmonë shfaqet në momentet kyçe. Ronaldo është një lojtar themelor", u shpreh is-futbollisti i Realit. Në pyetjen se a është ai më i miri në botë, Salgado u përgjigj: "Pa asnjë dyshim, tani. Është një vlerësim personal. Ajo që ne jetojmë nuk është parë kurrë. Pele, Maradona, si Kristiano dhe Messi, kurrë. Kristiano dhe Messi janë të ndryshëm, por të dy janë 'kafshë' futbollit. Ata do të kujtohen përgjithmonë. Ajo çfarë duhet të bëni është të kënaqeni me ta dhe t'i falënderoni. Shpresojmë se në të ardhmen të kemi dy, ose tre lojtarë të tjerë si ata. Ajo që i japin futbollit është mbresëlënëse", deklaroi Salgado.

Publicitet

Sipas nenit 46-b të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përbarim Gazeta Zyrtare e RM nr. 8 të datës 17.01.2008 ndërsa në lidhje me nenin 265 të LP Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2016 të datës 12.04.2016

SHPALLJE PUBLIKE I nr. 1958/2016

1. Borxhliun Ardjan Ramadani dhe debitorin e pengut Qemal Ramadani të dy nga Gostivari me seli në f. Bellovishitë, për shkak të dorëzimit të: -Konkluzionit për mënyrën e shlyesjes së patundshmërisë I nr. 1958/2016 të datës 14.07.2017.

2. Personin Zhivka Ançevska nga Shkupi me banim në bul. Ilinden 9-4 për shkak të dorëzimit të: -Konkluzionit për mënyrën e shlyesjes së patundshmërisë II nr. 1958/2016 të datës 23.11.2017.

-Konkluzion për shlyerjen publike me gojë në bazë të nenit 169, nenit 169, nenit 170 të LP I nr. 1958/2016 të datës 23.11.2017 të gjitha të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari.

-Raport për vlerën e realizuar të vlerës së tregut të pronës së patundshme nr. 0802-355/2 të datës 20.11.2017 të Shoqërisë për shërbime MEDIUS TERRA SHPKNJIP Shkup.

-Lajmërimin nga data 29.11.2017.

-Konkluzion për shlyerjen publike me gojë në bazë të nenit 169, nenit 169, nenit 170 të LP I nr. 1958/2016 të datës 23.11.2017 të gjitha të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari.

Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHEN borxhliu Ardjan Ramadani, debitor i pengut Qemal Ramadani dhe personi Zhivka Ançevska se mënyra e këllitë e dorëzimit konsiderohet si e rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vetë pala.

Kjo shpallje paraqet SHPALLJEN E TRETË.

Përbaruesi
Aleksandar Kuzmanovski

MOHON RINOVIMIN ME SITIN

“Nuk di asgjë. Askush nuk më ka folur për këtë temë. Drejtuesit e Sitit nuk më kanë thënë asgjë dhe as menaxheri im. Nuk ka ndodhur asgjë e re dhe përqendrimi im është maksimal për të dhënë më të mirën në fushën e lojës për Mançester Sitin”, pohon Jesus

Gabriel Jesus deklaroi se nuk di asgjë në lidhje me zërat që flasin për një kontratë të re me Mançester Sitin. Sulmuesi nga Brazili, i cili ka lënë një përshtypje shumë të mirë, që pas mbërritjes në “Etihad Stadium” në janar 2017, është shumë pranë një marrëveshje të re me ekipin e Pep Guardiolas, sipas asaj që shkruan shtypi britanik. 20-vjeçari, i cili ka shënuar 20 gola në 35 ndeshje me fanellën e Sitit, ka edhe katër vite kontratë të mbetur nga marrëveshja aktuale. “Nëse nuk luaj mirë, atëherë trajneri ka të drejtë të më zëvendësojë. Guardiola po bën një punë shumë të mirë, duke përdorur shumë lojtarë dhe secili prej tyre po e ndihmon ekipin e Sitit të përmirësohet”, u shpreh Jesus. I pyetur në lidhje me rinovimin e mundshëm, Jesus tha. “Nuk di asgjë. Askush nuk më ka folur për këtë temë. Drejtuesit e Sitit nuk më kanë thënë asgjë dhe as menaxheri im. Nuk ka ndodhur asgjë e re

dhe përqendrimi im është maksimal për të dhënë më të mirën në fushën e lojës për Mançester Sitin”, shtoi më tej braziliani. Jesus ka luajtur shumë mirë në krah të Sergio Agueros, por gjithashtu i jep trajnerit Guardiola një alternativë të rëndësishme, kur një prej qendër-sulmuesve do të pushojë. “Nëse një futbollist luan më mirë se unë në rolin tim, atëherë më duhet ta pranojë dhe të qëndroj në stol. Nëse nuk luaj mirë, atëherë trajneri ka të drejtë të më zëvendësojë. Guardiola po bën një punë shumë të mirë, duke përdorur shumë lojtarë dhe secili prej tyre po e ndihmon ekipin e Sitit të përmirësohet. Kjo është kryesorja”, deklaroi Jesus. Cekim, me 46 pikë, 11-të më shumë se Junajtedi, Siti mban pozitën e parë në Premier Ligë.



Real dhe Arsenali nisin garën për Drakslerin

Real Madridi do të lëvizë në merkaton e janarit për të marrë sulmuesin e Paris Sen Zhermen, Julian Draxler. Arsenali ishte i gatshëm të merrte futbollistin gjerman gjatë verës, por dështoi në arritjen e marrëveshjes sepse u kujtua vetëm në ditët e fundit të verës. Sipas “Bild”, Real ka nisur të interesohet për Draxler dhe do të ishte gati për huazimin e tij në janar 2018. Draxler ka qenë gjithmonë i preferuar nga Wenger, por ai zgjodhi të shkojë në Paris, kur u largua nga Bundesliga. Shanset e Arsenal janë shtuar nga fakti që Draxler ka përfunduar në stolin e PSZH, pas blerjeve të Neymar dhe Mbappe, por tani do të përballlet me konkurrencën e Real Madridit.

“
Nëse nuk luaj mirë, atëherë trajneri ka të drejtë të më zëvendësojë. Guardiola po bën një punë shumë të mirë, duke përdorur shumë lojtarë dhe secili prej tyre po e ndihmon ekipin e Sitit të përmirësohet

Publicitet

RIHAPET ÇËSHTJA “DONNARUMMA”

Raiola kërkon anulimin e kontratës së nënshkruar

Mund të jetë problemi i fundit që shqetëson Milanin, por nuk duhej aspak në këto momente. Sipas “Corriere Dello Sport”, klani i menaxherit të Donnarummas (Mino Raiola) kërkon anulimin e kontratës së nënshkruar gjatë verës, pasi pretendon se portieri 18-vjeçar ka pësuar dhunë morale. Kjo do të thotë se çështja “Donnarumma” po rihapet në mënyrë krejt të papritur. Gigio ka firmosur me Milanin një kontratë të vlefshme deri në vitin 2021 me një pagë 5.5 milionë euro në sezon, plus bonuset. Në marrëveshje ishte parashikuar vendosja e një klauzole të dyfishtë: 70 milionë euro në rast kualifikimi në Çampions dhe 40 nëse Milani nuk do të renditet mes katër vendeve të para. Kjo klauzolë nuk është firmosur në kontratën që është depozituar në Ligë, që do të thotë se ligjrisht nuk ekziston. Tani drejtuesit e Milanit mund t'i vendosin një çmim edhe më të lartë portierit, çka do të sillte një përplasje të pashmangshme me menaxherin Mino Raiola.

Barcelona gjen zëvendësuesin e Maskeranos

Barcelona ka marrë në konsideratë blerjen e Jerry Mina nga Palmeiras në muajin janar, pasi Javier Maskerano kërkojë të largohet nga klubi në muajin e ardhshëm. Barcelona ka opsionin e parë për të marrë 23-vjeçarin, i cili do të kushtojë 10 milionë euro deri në verën e ardhshme, atëherë kur Palmeiras do të jetë i lirë që të rrisë çmimin. Gjithsesi, trajneri Ernesto Valverde ka kërkuar një qendërmbrojtës për merkaton e janarit, jo vetëm për të zëvendësuar Maskeranon, por edhe Samuel Umtiti, i cili nuk do të luajë deri në fund të shkurtit 2017, si pasojë e një tërheqje muskulore. Xhaxhi i Mina, Jair Mina, i cili është njëkohësisht edhe menaxheri i tij, deklaroi: “Isha në Sao



Paolo gjatë javës së kaluar dhe fola me drejtuesit e Palmeiras, pasi kisha pasur një kontakt edhe me Barcelonën. Kjo është e vërteta, duke parë të gjitha rrethanat kemi vendosur të presimi dhe në janar të shohim se çfarë do të ndodhë me të ardhshmen e Jerry.

udhërrëfyes mjekësi
FAQ. 133

udhërrëfyes mobilie/ndërtimtari
FAQ. 153

libri i artë

2017/18

LAGERMAX 5% ZBRITJE
SPEKTRUM SERVICE
EURO-AS
ARRIKTON 5% ZBRITJE
ASANI GROUP CERAMICA IMOLA
BFM

ZBRITJE DHE GRATISE
24 KUPONË PREMIUM

LEHTË DERI TEK INFORMACIONI

www.zk.mk android app. iPhone app.



Më shumë se 1 mijë babadimra vrapojnë në Gjermani

Më shumë se 1000 persona të veshur në rroba të Babadimrit, kanë vrapuar nëpër rrugët e Michendorf afër Berlinit, për të shënuar këtë aktivitet tradicional në kuadër të festimeve për Krishtlindje. Rreth 1100 të rritur dhe fëmijë, i rezistuan kohës së ftohtë për të qenë pjesë e garës e cila dallonte nga 1-10 kilometra gjatësi. Benedikt Statt, i cili fitoi garën për meshkuj në 10 kilometra gjatësi ka thënë se "është me të vërtetë ndjenjë e mire, atmosferë e mirë, kohë perfekte. Ishte kënaqësi".

2200 euro në muaj çdo qytetari kundër varfërisë



Në Zvicër ka nisur të eksperimentohet projekti për "të ardhurat bazë të pakushtëzuara". Një nismë që synon t'u sigurojë të gjithë qytetarëve, të ardhura minimale për të jetuar, pavarësisht nëse janë apo jo të punësuar. Projekti nisi testimin në qytetin e Cyrihut, me vendim të këshillit komunal, pavarësisht se zviceranët e refuzuan këtë nismë në referendumin e vitit të kaluar. Sipas projektit çdo qytetari i garantohen minimalisht 2200 Euro në muaj. Minorenëve rreth 550. Bëhet fjalë për shumën që i mbajnë banorët e Cyrihut mbi kufirin e varfërisë,

bazuar gjithmonë tek standardi zvicerian. Procedurat e aplikimit dhe mënyra e shpërndarjes së parave janë ende të paqarta për publikun. Por projekti shihet me tepër skepticizëm, pasi mund të nxisë rastet e braktisjes së punës. Megjithatë ky sistem social është në faza eksperimentale edhe në Finlandë e Kaliforni. Plani është pjesë e projekteve të Kombeve të Bashkuara kundër varfërisë. Shumë organizata ndërkombëtare kanë në plan ta shtrinë në të gjithë globin në një periudhë afatgjatë, për të luftuar varfërinë.

Me misër kundër kolesterolit në gjak

Misri vazhdon të jetë numër një për të mbajtur konstant nivelin e kolesterolit në gjak, pasi ul ndjeshëm grafikun e yndyrës në gjak. Ai luan rol në prodhimin e energjisë trupore të njeriut. Misri është një burim i vërtetë proteinash dhe vitaminash. Në një studim të bërë me meshkuj të cilët kishin kolesterol të lartë, pas një trajtimi me produkte misri, si dhe me ushqime të varfra në yndyrë, u arrit në rezultate mjaft të kënaqshme. Misri gjithashtu është burim energjie, sepse përmban vitaminën B, të domosdoshme për njeriun. Në vendin tonë një përdorim të veçantë ka zënë "buka e misrit" dhe gjithmonë është rekomanduar për njerëzit që vuajnë nga hipertensioni.



Pse duhet të ndalojmë së konsumuari çamçakëz

Në të gjitha reklamën e çamçakëve që shohim thuhet çdo ditë në televizion, këshillohet të përtypim një të tillë pas çdo vakti. Është e vërtetë që mund të largojë aromën e keqe të gojës, por fatkeqësisht ka edhe disa efekte negative të cilat duhet t'i lexoni patjetër. "Çamçakëzi është armiku kryesor i dhëmbëve të mbushura", shprehen stomatologët. Gjithashtu na bëjnë me dije se çamçakëzi dëmton edhe zmalin e dhëmbëve, i cili është një ndër faktorët kryesorë i cili i mban dhëmbët tonë të shëndetshëm.



KALENDARI HISTORIK 13 DHJETOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS

1570 - Suedia dhe Danimarka kanë nënshkruar Paqen e Stetin.

1642 - Zbulohet Nju Zelandi nga lundruesi holandez Abel Tasman.

1734 - Anglia dhe Rusia nënshkruajnë traktat të tregtisë.

1823 - Xhoakino Rosini arrin në Londër.

1913 - Mona Lisa e vjedhur në gusht të vitit 1911 kthehet në Luvër.

1920 - Holanda ndërpret kontaktet me mbretërinë e Serbo-kroato-slovene.

1944 - Kamikazët japonez shkatërojnë anijen e madhe amerikane Nashville, duke vrarë 138 persona.

1965 - Presidenti algjerian Boumediene viziton Moskën.

1974 - Malta shpallet republikë.

1990 - Tërmet i rëndë në Sicili.

1990 - Presidenti De Klerk i Afrikës Jugore takohen me Mandelën për të biseduar në lidhje me përfundimin e aparteidit.

2003 - Ish kryetari irakian Saddam Hussein zihet afër shtëpisë së tij në Tikrit (shih Operacionin Agimi i Kuq).

Në Suedi jetojnë 20.000 banorë të minoritetit Sami ku që nga viti 1993 ata kanë parlamentin e tyre dhe në vitin 2000 gjuha Sami është pranuar zyrtarisht.



Suedia ka rreth 9.7 milionë banorë, ku 23% prej tyre janë nën moshën 20 vjeçare dhe 15% kanë lindur në një vend tjetër.



Prindërit suedezë kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë 480 ditë pushim të paguara për kujdesjen e fëmijës, ku 60 ditë janë të rezervuara për baballarët.



KOLLITU MORE KOLLITU

PACIENTI:

Doktor a keni diçka kundër kollit?

DOKTORI:

Jo asgjë, kollitu lirshëm!



Më pyet se cili ka qenë progresi im? Kam filluar të jem mik i vetvetes.

(Lucio Anneo Seneca)